



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Histori-Gjeografi”

i

Institucionit të Arsimit të Lartë,

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Merita DOLLMA

2. Prof. Asoc. Dr. Çlirim DURO

Maj/2020

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Ismail Qemali” në Vlorë (UV) është një institucion publik i arsimit të lartë, i hapur me VKM-në, Nr. 105, datë 28.02.1994.

Ky institucion është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA), me Nr. 71, datë 21.09.2017, me kohëzgjatje 3 vite akademike dhe me vlefshmëri deri më **30/09/2020**.

UV përbëhet nga 4 njësi kryesore, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Fakulteti i Shëndetit Publik dhe Fakulteti i Edukimit.

Fakulteti i Shkencave Humane përbëhet nga :

- *Departamenti i Edukimit*
- *Departamenti i Gjuhëve të Huaja*
- *Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë*
- *Departamenti i Drejtësisë*

Universiteti “Ismail Qemali” në Vlorë(UV), për vitin akademik 2019-2020, ka pasur aktive 64programe studimi në total, nga të cilat, 31 programe Bachelor, 20 programe Master Profesional, 12 program Master i Shkencave dhe 1 program doktorate (**doktoratura është e pezulluar**).

Programi i studimit në ciklin e parë të studimeve **Bachelor në “Histori-Gjeografi”** është hapur me Urdhërin e Ministrit të Arsimit Nr. 270, datë 10.06.2011, me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 3 vite akademike. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane. Regjistrimi i formës së diplomës është bërë me Urdhër të MASH Nr.439, datë 09.09.2011. Numri total i studentëve për vitin akademik 2019-2020 ka qenë 54 studentë.

Ky program studimi i ciklit të parë bachelor, është në proces akreditimi për herë të parë.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, i ofruar nga Departamenti i Edukimit, Fakulteti i Shkencave Humane, i Universitetit “Ismail Qemali” në Vlorë (UV). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve të ciklit të parë për Bachelorin, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet, konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.

Vlerësimi i jashtëm bazuar tek standardet e cilësisë për këtë program studimi është fokusuar në 6 fusha vlerësimi:

1. Ofrimi i programit të studimit;
2. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit;
3. Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat;
4. Burimet;
5. Studentët dhe mbështetja e tyre;
6. Sigurimi i cilësisë në programin e studimit.

Në manualin e vlerësimit të BA/ASCAL, shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Procesi i vlerësimit është bazuar në Manualin e Vlerësimit, i miratuar nga Bordi i Akreditimit (BA) dhe në përputhje me afatet e përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) sipas të cilave procesi i vlerësimit zgjat 106 ditë nga data 17.12.2019 deri në 22.05.2020.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjyqimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

I gjithë dokumentacioni i referuar, pasqyrohet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks.

Procesi i vlerësimit është koordinuar nga koordinatori teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS dhe gjatë vizitës në institucion.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga:

**Prof. Dr. Merita DOLLMA.**

**Prof. Asoc. Dr. Çlirim DURO.**

Koordinatorë teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Ersi DAKO.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet: Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV).
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë

hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në UV u zhvillua në datat 09 dhe 10 Mars 2020. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Gjatë vizitës në Institucion, vlerësuesit e jashtëm kërkuan disa materiale shtesë që koordinatori i institucionale e UV, me anë të sistemit AMS, i vendosi në dispozicion dhe që u përdorën nga GVJ gjatë hartimit të raportit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, pa-anshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UV.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 13.04.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 34/35 Prot., datë 14.03.2020, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 16.04.2020 dhe me shkresë zyrtare Nr. 573/3 Prot., datë 16.04.2020.

**Shënim:** Për shkak të Pandemisë së COVID-19, komunikimi me IAL është bërë vetëm nëpërmjet sistemit AMS, bazuar në Urdhërin e MSHMS Nr. 132, datë 09.03.2020, Urdhërin e MASR Nr. 91, dt. 09.03.2020, Urdhërin e MSHMS Nr. 190, datë 19.03.2020.

### **Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi shqyrtoi me seriozitet komentet e IAL-së, argumenton si në vijim:**

1. Referuar komentit të IAL për standardin II.1/II.5, kriteret 5,6/5, GVJ shprehet se i qëndron rekomandimit që ka bërë në Draft-Raportin e dërguar IAL-së. Kjo bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3, i cili shprehet: “Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, **titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore shkencore...**”.

2. Referuar komentit të IAL për standardin II.5, kriteret 2, 3, GVJ shprehet se e merr në konsideratë sqarimin e ofruar nga IAL dhe ndryshon komentin si vijon: “GVJ konstaton se, bazuar në Udhëzimin e MASR Nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, Kreu II, pika 1., i cili shprehet “Në raste specifike, me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë”, Institucioni nuk dispononte një vendim të drejtuesit të njësisë kryesore, për një shtesë në orë mbi 200 orët suplementare. Në dokumentacionin e sjellë nga Institucioni (komentet pas dërgimit të Draft-Raportit) GVJ-së, ju vu në dispozicion

*një shkresë përcjellëse e Dekanatit mbi këtë problematikë (Shkresë Nr. 239/3 Prot., datë 23.07.2019). Kjo shkresë ishte kërkesë për një vendimarrje në një instancë më të lartë, ndonëse bazuar në udhëzimin e sipërpërmendur, duhet të ishte vendim miratimi i titullarit të njësisë kryesore. Theksojmë se, numri i orëve që janë mbi normën është i papërfillshëm (20 orë), por rekomandimi i GVJ-së është për të ardhmen, që të mund të shmangen edhe këto anomali të vogla”.*

3. Referuar komentit të IAL për standardin III.2, kriteret 2, 4, GVJ shprehet se i qëndron konstatimit për mos gjetjen e formave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve që mund të ndërthuren me teknologjinë. Në sqarimin e IAL-së, thjesht citohen nene të rregullores së Departamentit të Edukimit. Në vijim, në Draft- Raport (*duke e parë më tepër në aspektin e rritjes dhe përmirësimit të cilësisë*), është bërë rekomandimi që, në të ardhmen, vlerësimi i dijeve (*duke futur teknologjinë*) të mund të zhvillohen me anë të programit **Clean Score të AADF-së / FSHAZH**.

4. Referuar komentit të IAL për standardin III.3, kriteri 4, GVJ shprehet se i qëndron shqetësimit të shprehur në Draft-Raport për mungesën e disa teksteve bazë, pasi kjo gjë na u tha gjatë takimit që GVJ-ja zhvilloi me studentët e programit të studimit Bsc. në “Histori-Gjeografi” (*në prani edhe të ASCAL*) dhe për më tepër, ishte evidente mungesa e këtyre teksteve në bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Humane.

5. Referuar komentit të IAL për standardin IV.1, GVJ shprehet se e merr në konsideratë sqarimin e ofruar nga IAL dhe GVJ ndryshon komentin si vijon: “*Nga verifikimi i dosjeve të rastësishme nga GVJ, u konstatua prania e dokumenteve bazë (CV, diploma, listë notash, librezë pune, etj). Dokumente që vërtetojnë ecurinë akademike të stafit (certifikata trajnimesh apo konferencash që ndjek stafi çdo vit, fotokopje të botimeve të përvitshme) administrohen në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Publikimeve” (Shkresa Nr. 131/1 Prot., datë 16.04.2020).*

6. Referuar komentit të IAL për standardin IV.6, kriteri 1, GVJ konstaton se IAL nuk kundërshton komentin e bërë nga GVJ. Duke marrë në konsideratë komentin e IAL, GVJ, në standardin IV.6 shton edhe këtë koment: “*IAL shprehet se, duke filluar nga 2021, mendohet që të fillojë detajimi në nivel njësie bazë i buxhetit, me qëllim përlllogaritjen e kostos së studentit për program studimi” (Shkresa Nr. 131/1 Prot., datë 16.04.2020).*

7. Referuar komentit të IAL për standardin V.5, kriteri 3, se procedura e njohjeve të lëndëve dhe mobiliteteve të studentëve është e përcaktuar në rregullore të ICM (**Shkresa Nr. 576/2 Prot., datë 16.04.2020**), GVJ konfirmon se ky fakt nuk është mohuar nga GVJ, por nga takimi me studentët është konfirmuar ajo që është shkruar në raport. GVJ për Standardin V.5, kriteri 3, shton këtë koment: “*Nisur nga praktika e mirë e mobiliteteve të studentëve të programeve të tjera të studimit të UV, stafi akademik dhe ndihmës akademik i këtij programi mësimor duhet të nxisë aplikimin e studentëve për mobilitete duke i informuar dhe sqaruar studentët që, ekuivalentimi i lëndëve dhe njohja e mobiliteteve të tyre, janë të garantuara në rregullore” (Rregullore ICM, nenet 15, 16).*

8. Referuar komentit të IAL për standardin V.5, kriteri 4 (**Shkresa Nr. 576/2 Prot., datë 16.04.2020**), GVJ shprehet se, në Standardin V.5, kriteri 1 dhe 2, është argumentuar se Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe

përmirësimin e programeve të studimit. Kjo do të thotë që si procedurë përfshirja e studentëve ekziston, por si praktikë ende nuk është realizuar. Kjo është konfirmuar nga takimi i GVJ me studentët. Referenca mbështetëse që paraqet IAL në shkresën Nr. 576/2 Prot., datë 16.04.2020 (Urdhër Nr. 123, datë 19.12.2019) është për përfshirjen e studentëve për përmirësimin e pyetësorit për mësimdhënien, jo për programin e studimit. GVJ për standardin V.5, kriteri 4 shton këtë koment: *“Institucioni duhet të punojë për përfshirjen e rregullt të studentëve në hartimin dhe rishikimin e programit të studimit duke gjetur mënyra dhe instrumenta të tjerë (përveç pyetësorëve) që kontributi i tyre të jetë konkret, i matshëm dhe efektiv”*.

9. Referuar komentit të IAL për standardin VI.3, kriteri 2 (në shkresën e IAL Nr. 576/2 Prot., datë 16.04.2020 është shkruar gabimisht VI.1) GVJ, bën këto ndryshime: *“Për kryerjen e vlerësimit, Institucioni përdor metodën e analizimit të pyetësorëve me studentët, metodën e diskutimeve në Departament mbi përputhshmërinë dhe përshtatjen e programit mësimor me tregun e punës, organizimin e workshop-eve (Workshop-i “Studentët dhe tregu i punës), analiza e të dhënave të punësimit të studentëve alumni, si dhe diskutime informale të pedagogëve me studentët. Metoda që përdor aktualisht institucioni për përfshirjen e opinionit të studentëve është ajo e analizës së të dhënave sasiore të pyetësorit dhe interpretimit të rezultateve....GVJ mendon që institucioni dhe DE për vlerësimin e programit mësimor duhet të përdorë edhe instrumenta të tjerë përveç atyre të përmendura më sipër”*.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Histori - Gjeografi”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV) është një institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM-në Nr.105, datë 28.02.1994 dhe akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit (BA) Nr.71, datë 21.09.2017, për një afat 3 vjeçar, deri më 30/09/2020.</p> <p>Programet që ofron nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe janë në përputhje me profilin e institucionit [<b>Plani strategjik 2018-2024</b>]. Bazuar në statutin dhe rregulloren e IAL [<b>Statuti UV, rregullore e përgjithshme UV</b>], programet e ofruara nga UV synojnë përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme dhe janë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e UV [<b>Statuti i UV, pjesa qëllimet</b>]. UV ka fokusuar veprimtarinë e tij në katër drejtime kryesore, atë të shkencave humane, shkencave ekonomike, shkencave teknike-natyrore dhe shkencave të shëndetit publik (mjekësore), në këtë kuadër edhe programet janë në këto drejtime studimi.</p> <p>Sipas raportit të vlerësimit të brendshëm (RVB), deklarimeve të drejtuesve të Fakultetit të Shkencave Humane (<i>Dekan, përgjegjës departamenti</i>), programet e studimit të ofruara nga kjo njësi kryesore bazohen në studime të kryera nga institucioni lidhur me nevojat që ka sidomos rajoni, por edhe vendi. Ata nga përvoja e tyre (<i>Dekani ishte hartuesi i kurrikulës Histori-Gjeografi</i>) na deklaruan në takimin e kryer se në vitin 2011, kishin marrë të dhëna nga Drejtoria Rajonale Arsimore e Vlorës, në të cilën vihej në dukje mungesa e madhe për mësues në këto fusha (Histori dhe Gjeografi). Bazuar në këtë të dhënë nga tregu i punës është bërë kërkesa për të hapur këtë program studimi (<i>kjo mungesë në tregun e punës është cituar edhe në kërkesën e përgjegjës të departamentit në vitin 2011, si arsye për hapjen e këtij programi studimi në vitin 2011</i>) [<b>Evidenca 1.1, fq 1</b>].</p>			
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.				
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.				
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një strategji zhvillimi në vitet 2008-2017 (<i>të cilin e gjejmë të cituar te strategjia e 2018-2024</i>) dhe plan të ri strategjik të zhvillimit 2018-2024, të miratuar nga Senti Akademik datë 01.10.2018 me numër protokolli Nr. 65, por që ne si GVJ nuk disponojmë vendimin e miratimit nga ana e Bordit të Administrimit për këtë plan strategjik, kjo sipas përcaktimeve të ligjit të arsimit të lartë 80/2015, neni 49 pika b <b>[strategjia 2018-2024]</b>. <i>GVJ vëren se në këtë strategji të re, institucioni ka të përcaktuara qartë drejtimit strategjike të zhvillimit të programeve dhe fushave të studimit dhe kërkimit të cilat të jenë në përputhje me fushën e veprimtarisë së UV.</i></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Statuti i UV është miratuar me Urdhër Nr. 197, datë 01.04.2019, të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë. Rregullorja e përgjithshme është miratuar me Vendim Nr. 09, datë 15.02.2013 të Senatit Akademik dhe ka ndryshuar 8 herë para se të miratohej ligji i ri i arsimit të lartë 80/2015. Me ndryshimin e ligjit, Institucioni nuk ka bërë një rregullore të re por ka amenduar atë edhe 6 herë të tjera. UV ka hartuar dhe miratuar edhe rregulloret e njëjshme dhe strukturave të tjera <b>[Rregulloren e fakultetit, rregullore e departamentit, rregulloren e programit të studimit Histori-Gjeografi, etj.]</b>. <i>GVJ vë re se, për shkaqe që i përmendem më lart, evidentohen referenca nga legjislacioni i mëparshëm. Në këtë kuadër GVJ rekomandon të realizohet një rregullore e re për UV, në të cilën të rishikohen dhe përditësohen aktet e brendshme rregullatore në përputhje me Statutin dhe LAL 80/2015.</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga institucioni janë në përputhje me fushën e veprimtarisë së IAL dhe katër drejtimit kryesore që ai ofron, shkencë ekonomike, teknike, edukimit dhe mjekësore <b>[Evidenca 1.3, fq 2, lista e programeve të DE]</b>. Programet e studimit të ofruara nga institucioni janë hapur në faza të ndryshme të funksionimit të tij. <i>GVJ nuk identifikoi të dhëna apo studime të mirëfillta dhe propozime për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</i> Megjithatë, gjatë takimeve të zhvilluara GVJ u informua që personeli akademik apo drejtuesit vazhdimisht informohen në rrugë të ndryshme mbi nevojat e tregut të punës, kryesisht në Qarkun e Vlorës, Fierit, etj.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.3</b> <b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë</p>	<p>Programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Histori-Gjeografi” ka dy objektiva të përcaktuara qartë në të cilat përfshihen: (a) dijet dhe b) aftësitë e kompetencat profesionale dhe analitike që në fund të programit duhet të fitojnë studentët. Bazuar në këto objektiva, programi synon të përgatisë profesionistë të</p>



<p>studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>shkencave të Historisë dhe Gjeografisë, të cilët të jenë të aftë profesionalisht të punojnë në sektorin publik dhe atë privat <b>[rregullore e programit të studimit neni 2]</b>, kryesisht në mësuesi, por edhe në parqe arkeologjike, në qendra muzeale, në guida turistike, etj.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit, ne si ekspertë të jashtëm, <i>nuk evidentuam raste konkrete studimi të tregut të punës që kanë orientuar hapjen dhe zhvillimin e programeve në tërësi nga kjo njësi kryesore apo për këtë program studimi në veçanti.</i> Ndonëse në strategjinë e zhvillimit 2008-2017, është theksuar domosdoshmëria e hartimit të kurrikulave të përshtashme bazuar në sfidat e ekonomisë së tregut jo vetëm kombëtare por edhe ato ndërkombëtare <b>[Në planin strategjik 2018-2024, fq 14 e gjejmë të cituar strategjinë e 2008-2017]</b>. Mungesa e studimit të tregut, është relatuar edhe në RVB, gjithashtu kjo mungesë ju bë e ditur GVJ-së dhe në takimin e zhvilluar me Dekanin dhe përgjegjësën e departamentit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p><i>Nga ana tjetër, referuar edhe planit për zhvillimin strategjik të Departamentit të Edukimit (DE) 2017-2024, në të cilin parashikohet që për zhvillimin e programeve të reja të studimit (nga ky Departament) ato duhet të jenë në të njëjtën linjë me zhvillimet social-ekonomike të vendit, apo politikat rajonale të Qarkut të Vlorës.</i></p> <p>Nga vizita në institucion, GVJ identifikoi se personeli akademik dhe drejtuesit, në mënyra të ndryshme, marrin informacione për nevojat e tregut të punës në rajonin e Vlorës dhe i reflektojnë ato në përmbajtje të programit. Një e dhënë me shumë interes për këtë standard na u dha në disa takime por edhe e pasqyruar në RVB (<i>kriteri 2 Standardi I.3</i>) në të cilën shpалosen të dhëna mbi studime në rang institucional nga Qendra e karrierës dhe Alumni në të cilin ne shohim përpjekje të Institucionit për ta institucionalizuar këtë proces. Në këto studime objektivi ka qenë gjurmimi i ecures së studentëve në tregun e punës.</p> <p><b>GVJ rekomandon që Departamenti i Edukimit si njësi bazë e FSHH-së, njëkohësisht si struktura që ligji 80/2015 i jep të drejtën e përgjegjësisë së programeve të studimit (ndryshe nga ligji i vjetër që ja jepte këtë të drejtë Fakultetit) të kryejë një studim të përgjithshëm mbi nevojat e tregut të punës në lidhje me 6 programet që ajo ofron (ku të përfshihet me detyrim dhe programi Bsc. Histori-Gjeografi).</b> Të dhënat e mbledhura nga burime të ndryshme, përfshirë edhe studentët e diplomuar, të analizohen dhe të hartohet një dokument analitik me propozime konkrete në kuadër të përmirësimit të programit të studimit (<i>fokusi jonë është Bsc. Histori-Gjeografi</i>).</p> <p>Programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi është i organizuar në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, e për këtë arsye objektivat formuese, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, që matin rezultatet e pritshme të të nxënit, që garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut e që mundësojnë punësimin e shpejtë të studentëve, janë pasqyruar në raport me detyrimet e VKM-së më sipër.</p> <p>Programi i studimit i krijon mundësi studentit bazuar në ndarjen që VKM-ja imponon) të marrë njohuri në lëndë bazë të grupit A, në lëndë karakterizuese të grupit B, në lëndë ndërdisiplinore/integruese të grupit C</p>

	dhe në lëndë plotësuese të grupit D. Detyrimet përmbyllëse realizohen me temë dipome e cila i përket grupit E (në standardet më poshtë do të japim të dhëna më specifike për secilin nga grupet e përmendura më lart).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi I.4</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV) është një institucion publik i arsimit të lartë, i licensuar me VKM-në Nr. 105, datë 28.02.1994. Institucioni, siç duket nga licensimi, ka një përvojë të konsiderueshme prej rreth 26 vitesh në mësimdhënie.
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fakulteti ka 13 vite që funksionon (ka filluar veprimtarinë si FSHH në vitin 2007) ndërsa programi i studimit Bsc. në “Histori-Gjeografi” e ka filluar veprimtarinë e tij para 9 vitesh, çka tregon se tashmë institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon. Fakulteti përbëhet nga katër departamente, të cilat kanë në përbërjen e tyre kapacitete akademike 71 (54 PAE, 9 PAK, 8 personel ndihmës-akademik) që bëjnë të mundur ofrimin e programeve përkatëse. Departmenti i Edukimit, si përgjegjës për programin e studimit Histori-Gjeografi, ka në përbërjen e tij 18 personel akademik efektiv, 7 personel akademik me kontratë dhe 1 personel ndihmës-akademik. DE është përgjegjës për 6 programe studimi, ndërsa stafi i dedikuar për programin e studimit Bsc. në “Histori-Gjeografi” është 9 PAE dhe 2 PAK [Aneksë, tabela 1.4, 6.4].
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programet e studimit që ofrohen nga Departmenti i Edukimit janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>– Bachelor në “Histori-Gjeografi”;</li> <li>– Bachelor në “Mësuesi për ciklin parashkollor”;</li> <li>– Bachelor në “Mësuesi për ciklin e ulët”;</li> <li>– Master profesional në “Mësuesi për ciklin parashkollor”;</li> <li>– Master profesional në “Mësuesi për ciklin e ulët”;</li> <li>– Master i Shkencave në “Pedagogji e specializuar”.</li> </ul> Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore që janë shkencë humane (kjo bazuar dhe në ndarjen sipas manualit të FRASCATI). Programi i studimit ofrohet nga Departmenti i Edukimit, fusha e veprimtarisë të së cilit përputhet me atë të programit të studimit. Departmenti ka bërë një punë paraprake për të bërë të mundur kodifikimin e lëndëve të programit të studimit Histori-Gjeografi, por kodifikimi i programit të studimit ende nuk është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane pasi nuk është finalizuar akti nënligjor i cili udhëzon institucionet se si duhet kryer ky proces [Ligji i arsimit të lartë 80/2015, neni 86]. Në takimet në Institucion u shpreh dhe shqetësimi që akoma nuk

	<p>ështëzbatuar ligji i arsimit të lartë neni 86 pika 2, e cila flet “për programet e studimit, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind”, kjo për arsye mobiliteti brenda vendit, por edhe me gjerë. Niveli i njohurive që ofron programi i studimit Histori-Gjeografi, përkon me atë të nivelit 6 të Kornizës Shtetërore të Kualifikimit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë (UV) është një institucion publik relativisht me një jetë prej 26 vitesh dhe kjo përbën një përvojë të konsidueshme në ndarjen e detyrave për mbarëvajtjen e programeve dhe të programit që kemi nën akreditim.</p> <p>Nga takimet me drejtuesit, na u vu në dukje se Institucioni ka evoluar dhe është përmirësuar në këtë drejtim, sidomos pas përvojës shume të mirë në Akredimin Institucional, por dhe në akreditimet e programeve që sapo kanë filluar. Në takimet në institucion na u theksua edhe ndihma e madhe që i ka dhënë ASCAL në shumë nga problematikat që kanë hasur në këtë drejtim apo dhe në të tjera <b>[takimi me Koordinatorin Institucionale të UV]</b>.</p> <p>Sipas dokumentacionit që GVJ konsultoi, RVB-së dhe takimeve në institucion, vumë re se në ndarjen e detyrave në mbarëvajtjen e programit, Institucioni është mbështetur në Statutin dhe rregulloren e përgjithshme të UV (<i>ndonëse e pa përditësuar</i>), në rregulloren e FSHH dhe në rregulloren e Departamentit.</p> <p>Sikundër u theksua edhe gjatë vizitës në institucion nga drejtuesit, bashkëpunimi dhe koordinimi brenda institucionit zhvillohet në normalitet. Disa anëtarë të personelit akademik mbulojnë pozicione të ndryshme në strukturën e institucionit ose në komisione të ngritura për tematika të ndryshme (<i>psh një nga DE, ishte dhe anëtar në Bordin e Administrimit të UV</i>).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	<p>Institucioni (UV) në funksion të programeve të tij të studimit ka bashkëpunime të mira me shumë Universitete brenda dhe jashtë vendit, biles për këtë ka hartuar dhe <b>strategjinë e ndërkombëtarizimit [Evidenca D]</b>.</p> <p>Në funksion të programit të studimit Histori-Gjeografi, për të realizuar objektivat e këtij programi, është vendosja e marrëdhënieve me institucione të ndryshme të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, institucionet në rajonin e Vlorës-Fierit (sidomos DAR, parqet arkeologjike, muzetë, etj.) publike dhe private <b>[RVB standardi 1.5,</b></p>

	<p><b>kriteri 2].</b>  <i>Gjithsesi, ne si GVJ, mendojmë se në funksion të këtij programi, të shtohen numri i marrëveshjeve së pari brenda vendit, sidomos për pjesën e gjeografisë dhe më pas edhe me institucionet rajonale dhe me gjerë.</i>          Raporte analitike specifike në funksion të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit, njësia nuk harton, por keto analiza jepen në kuadrin e hartimit të raportit vjetor të UV (detyrim ligjor) <b>[evidenca J].</b>          Në takime me drejtuesit, na u tha që specifikisht për programin e Histori-Gjeografisë ka pak bashkëpunime, kështu që edhe përvoja e pakët e përfituar analizohet në takime të hapura të departamentit.  <i>GVJ mirëkupton vështirësitë që has institucioni në bashkëpunime specifike për programin Histori-Gjeografi, por gjithashtu rekomandon që të gjitha veprimtaritë që kryhen (aq sa janë deri tani, porqë në të ardhmen mund të shtohen) në kuadër të realizimit të proceseve akademike dhe administrative në funksion të programit të studimit, të ruhen, administrohen, analizohen dhe raportohen në përputhje me aktet e brendshme të miratuara nga ana e institucionit.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Histori Gjeografi ” është hapur për herë të parë në bazë të Urdhërit Nr. 270, datë 10.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës. Programi i studimit ofrohet nga Departamenti i Edukimit, FSHH, i referohet nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ( <i>e thënë edhe më lart</i> ) dhe organizohet në 180 ECTS. Programi është me kohë të plotë dhe realizohet në 3 vite akademike të ndarë në 6 semestra, të cilat ndahen në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe rregulloren e programit të studimit [ <b>Aneksi I, tabela 9</b> ]. <b><i>GVJ thekson se rregullorja e programit të mësimit në nenin 13 të saj duhet të ndryshohet pasi, bazuar në udhëzimet e MASR Nr.29, datë 10.09.2018, ora mësimore është 50 minuta dhe jo 60 minuta.</i></b> Në këtë program studimi kemi: lëndë bazë 38 ECTS, lëndë karakterizuese 98 ECTS, lëndët ndërdisiplinore/integruese 28 ECTS, lëndë plotësuese 8 ECTS dhe tema e diplomës ka 10 ECTS. Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” përmban një informacion të plotë në fushën e Historisë-Gjeografisë, por edhe të didaktikës. Ky informacion i shërben studentit për marrjen e njohurive në fushat specifike dhe të specializuara që ky program bachelor ofron si dhe në përfitim të aftësive profesionale dhe kompetencave për të shërbyer më mirë tregut të punës. Programi i studimit reflekton nevojat që ka tregu dhe ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit [ <b>Evidenca D, plani strategjik, Evidenca I.5 rregullorja e programit të studimit dhe Aneksi I, tabela 9, plani mësimor</b> ]. Me njohuritë e fituara në këtë program studimi, studentët kanë mundësi të përshtaten me kërkesat e tregut të punës dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre profesionale në studime të mëtejshme në ciklet pasardhëse. <b><i>Në të gjitha takimet që GVJ zhvilloi në Institucion (duke përfshirë dhe atë me studentë) na u theksua nevoja e një cikli të dytë pasardhës, ajo e një Masteri Profesional Mësuesi në Histori-Gjeografi.</i></b>  Programi i studimit Histori-Gjeografi është i organizuar me kohë të plotë në tre vite akademike të ndarë në 6 semestra në total 180 ECTS ( <i>ose 1830 orë mësimore në auditor</i> ) [ <b>Aneksi I , tabela 9, plani mësimor</b> ]. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të gjashtë semestrat janë organizuar në leksione, seminare, praktikë profesionale si dhe orët jashtë auditorit. Frekuentimi i orëve në auditor është i detyrueshëm për studentin në masën 75% [ <b>Evidenca I.5 rregullorja e programit të studimit</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.	
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	

	<p>Lëndët e programit realizohen sipas orarit mësimor të miratuar nga Dekani i Fakultetit, shpallur në website-in e Institucionit si dhe në ambientet e njësisë kryesore. <i>GVJ konstaton se orari është miratuar nga drejtues i fakultetit ashtu siç parashikohet në rregulloren përkatëse dhe e quan një praktikë të mirëdhe të vlerësuar edhe nga studentët [Evidenca I.5 rregullorja e programit të studimit].</i></p> <p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore është bazuar në ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, neni 59 pika 8 dhe në udhëzimet e MASR Nr. 29, datë 10.09.2018. Gjatë vizitës në institucion GVJ shqyrtoi dokumentin lidhur me shpërndarjen e ngarkesës mësimore për vitin akademik 2018-2019 dhe 2019-2020 të miratuara me vendim të Senatit Akademik dhe vlerësoi ndarjen sipas rregullores në fuqi. Ngarkesa mësimore përcaktohet në orët mësimore në auditor dhe përfshirja në aktivitete të tjera në dobi të njësisë.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga DE, FSHH për këtë program studimi, GVJ konstatoi se:</p> <p>Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59 pika 3, <i>titullari i lëndës duhet të jetë i kategorisë Profesor. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni në të gjitha lëndët e zhvilluara në këtë program me pak përjashtime mungon titullari i lëndës me këtë kategori.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.2</b> <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Edukimit në FSHH, si përgjegjës për programin e studimit Bsc. “Histori-Gjeografi”, i përmbush detyrimet ligjore për akreditimin e programit, pasi ka në përbërjen e tij 18 personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 personel akademik me kontratë (PAK). Në total, Departamenti ka në përbërjen e tij 26 personel akademik dhe ndihmës akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Departamentin e Edukimit (RVB-DVV) raporti personel akademik efektiv me personelin akademik me kontratë është si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>– për vitin <b>2019-2020</b> janë angazhuar 18 (<i>tetëmbëdhjetë</i>) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 7 (<i>shtatë</i>) pedagogë si personel akademik me kontratë.</li> <li>– për vitin <b>2018-2019</b> janë angazhuar 19 (<i>nëntëmbëdhjetë</i>) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 15 (<i>pesëmbëdhjetë</i>) pedagogë si personel akademik me kontratë.</li> <li>– për vitin akademik <b>2017-2018</b> janë angazhuar 20 (<i>njëzetë</i>) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 13 (<i>trembëdhjetë</i>)</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	
<b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe	

shkallën e kualifikimit të personelit akademik.	<p>pedagogë si personel akademik me kontratë.</p> <p>– për vitin akademik <b>2016-2017</b> janë angazhuar 19 (nëntëmbëdhjetë) pedagogë si personel akademik efektiv dhe 11 (njëmbëdhjetë) pedagogë si personel akademik me kontratë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Për sa më lart, personeli akademik efektiv në këto vite akademike, në departament, në aspektin numerik, <b>përbën: 72 % të stafit akademik për vitin akademik 2019-2020</b>; 56 % të stafit akademik për vitin akademik 2018-2019; 61 % të stafit akademik për vitin akademik 2017-2018 dhe 63 % për vitin akademik 2016-2017.</p> <p><i>GVJ, në vijim, paraqet të dhënat mbi personelin akademik efektiv dhe atë me kontratë (tituj, grada dhe master), sipas viteve:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik <b>2019-2020</b>, në Departamentin e Edukimit, janë angazhuar si pedagogë efektivë: 1 Prof. Asoc. Dr., 15 Dr. dhe 2 Msc., dhe si pedagogë me kontratë: 1 Prof. Dr dhe 6 Msc.</li> <li>- Për vitin akademik <b>2018-2019</b> janë angazhuar si pedagogë efektivë: 1 Prof. Asoc. Dr, 14 Dr., 1 Docent, 3 Msc. dhe si pedagogë me kontratë: 4 Prof. Dr, 2 Prof. Asoc. Dr, 1 Docent dhe 8 Msc.</li> <li>- Për vitin akademik <b>2017-2018</b> janë angazhuar si pedagogë efektivë: 1 Prof. Asoc. Dr, 15 Dr., 1 Docent, 3 Msc. dhe si pedagogë me kontratë: 3 Prof. Dr, 2 Prof. Asoc. Dr, 1 Dr, 7 Msc.</li> <li>- Për vitin akademik <b>2016-2017</b> janë angazhuar si pedagogë efektivë: 1 Prof. Asoc. Dr, 11 Dr., 1 Docent, 6 Msc dhe si pedagogë me kontratë: 3 Prof. Dr , 1 Dr dhe 7 Msc.</li> </ul> <p><i>GVJ konstaton se bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, në të cilin është përcaktuar se në procesin e mësimdhënies duhet të përfshihet personel akademik me një formim më të lartë se cikli paraardhës, stafi mësimdhënës i plotëson kriteret ligjore.</i></p> <p>Nga verifikimet për stafin e institucionit që ushtrojnë funksione drejtuese konstatojmë se edhe stafi drejtues (Dekan dhe Përgjegjës Departamenti) i plotëson kriteret e përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë 80/2015.</p> <p>Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës administrativ dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione pune.</p> <p>Programi i studimit ka një koordinator të studentëve që luan rolin dhe të koordinatorit të programit të studimit, i cili është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion (<i>kualifikimi akademik është PhD</i>).</p> <p>Koordinatori i programit përgjigjet për realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale dhe marrëdhënive me studentët. Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuara në rregulloren e funksionimit të programit [<b>rregullorja e FSHH, rregullorja e departamentit</b>].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

### Standardi II.3

**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Grupi i ekspertëve të jashtëm, pas shqyrtimit të Dosjes së Vetëvlerësimit të programit të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, takimeve gjatë vizitës në UV dhe dokumentave shtesë pas vizitës në institucion, thekson se DE, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, programi i studimit është organizuar sipas Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” dhe rregullores së programit të studimit [Aneksi I, tabela 9].
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	GVJ, pas shqyrtimit të dosjes së vetëvlerësimit, RVB-së dhe dokumentacionit të paraqitur nga DE gjatë vizitës në institucion, konstatoi se programi i studimit është i organizuar në lëndë, aktivitete formuese dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Europian të transferimit të kreditve (ECTS) të cilat zhvillohen në tre vite akademike të ndara në 6 semestra.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	GVJ gjithashtu, konstaton se gjendet informacioni i nevojshëm lidhur me planin mësimor, ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit, mënyrën e vlerësimit të dijeve, mënyrën e frekuentimit të programit, orarin e zhvillimit të programit, etj. [Plani mësimor, rregullorja e programit, rregullorja e departamentit, etj].
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	GVJ, nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, konstaton se institucioni ka një informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin e studimit [rregullorja e FSHH, rregullorja e departamentit, rregullorja e programit të studimit ].
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në lidhje me kriteret përzgjedhëse, programi i studimit <i>nuk aplikon</i> kriteret të veçanta, përveç atyre që imponon VKM-ja e çdo viti nga ana e Qeverisë. <i>Në takime na u ngrit shqetësimi, se rritja çdo vit e notës mesatare në programin Histori-Gjeografi, ka bërë që në këtë program të këtë një ulje drastike të numrit të studentëve. Shqetësimi qëndonte jo se ata ishin kundër rritjes së notës mesatare që automatikisht përkthehet në rritje të cilësisë, po që ky program studimi nuk është specifikisht program mësuesie.</i>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Histori-Gjeografi”, ofruar nga Departamenti i Edukimit, përmban informacion lidhur me syllabuset që zhvillon programi, ndarjen në leksione, seminare, orët brenda dhe jashtë auditorit. Syllabuset e lëndëve janë të organizura dhe përmbajnë informacionin e nevojshëm, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi [VKM Nr. 41].



	GVJ konstaton se, gjatë vizitës në institucion, specifikisht takimit me stafin, kishte paqartësi për zbatimin e procedurave për përmirësime/ndryshime të programit të studimit nën apo mbi 20%. <i>GVJ rekomandon që strukturat përkatëse të informojnë stafin me ndryshimet ligjore në këtë drejtim.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënimit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi i studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi”, bazuar në ligjin e arsimit të lartë 80/2015, VKM Nr. 41 dhe në rregulloren përkatëse të programit të studimit është organizuar në leksione, seminare dhe praktikë [ <b>plani mësimor 2019-2020</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Ndarja në kategori (A, B, C, D dhe në E) është në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, <i>ndërsa ngarkesa në kredite (në %) për veprimtaritë formuese D, nuk përputhet plotësisht me legjislacionin në fuqi dhe duhet të ndryshojë</i> [ <b>Aneksi I, Tabela 9</b> ].
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional.	Shpërndarja e ngarkesës mësimore në program përcaktohet nga vetë Departamenti dhe ishte zbatuar ndarja sipas të Udhëzimit të MASR për ngarkesën mësimore Nr.29, datë 10.09.2018, i ndryshuar. Me detaje, ngarkesën mësimore e analizojmë tek standardi II.5.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi Bachelor në Histori-Gjeografi, është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre teorike në fusha të Historisë dhe Gjeografisë, të cilat të jenë të lidhura me kërkesat e tregut të punës, e në veçanti në rajonin e Vlorës [ <b>rregullorja e programit të studimit</b> ].
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/kredite ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Studentët në këtë program studimi në auditor marrin: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. 1187 orë leksione;</li> <li>2. 734 orë seminare;</li> <li>3. 75 orë forma të kontrollit në auditor;</li> <li>4. 230 orë Provim final.</li> </ol>
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<b>Në total 2226 orë mësimore [tabela 13].</b> Përmbajtja e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive dhe krijimin e kushteve të duhura për njëkompetencë të nevojshme në të ardhmen, kur ata të ushtrojnë profesionin e tyre ( <i>pas masterit</i> ). Ky program u krijon mundësi të thellohen në ciklin e dytë, Master
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të	

studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Profesional ose Master i Shkencave në fusha si Histori dhe Gjeografi. <i>GVJ mendon se në kushtet e një tregu shumë të vogël që ka vendi ynë kjo mundësi është një pikë fortë për këtë program. Kjo gjëu theksua edhe në takimet që patëm më stafin akademik por sidomos në takimin me studentët [takimi me studentët].</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Standardi II.5**  
**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) në programin e studimit Histori-Gjeografi përmbush kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga UV, listën e stafit akademik, planin mësimor të lidhur me stafin akademik, syllabuset e programit të studimit GVJ, shprehet si më poshtë:  Në këtë program studimi janë angazhuar: 1. Në vitin akademik <b>2019-2020</b> : janë 9 pedagogë efektivë dhe 2 pedagogë me kontratë. <b>Në aspektin numerik në % raporti për këtë vit akademik është 82 % PAE / 18 % PAK.</b> 2. Në vitin akademik <b>2018-2019</b> : janë 10 pedagogë efektivë dhe 2 pedagogë me kontratë. <b>Në aspektin numerik në % raporti për këtë vit akademik është 83 % PAE / 17 % PAK.</b> 3. Në vitin akademik <b>2017-2018</b> : janë 10 pedagogë efektivë dhe 2 pedagogë me kontratë. <b>Në aspektin numerik në % raporti për këtë vit akademike është 83 % PAE / 17 % PAK.</b> 4. Në vitin akademik <b>2016-2017</b> : janë 7 pedagogë efektivë dhe 3 pedagogë me kontratë. <b>Në aspektin numerik në % raporti për këtë vit akademike është 70 % PAE / 30 % PAK.</b>
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Në të gjitha vitet e mësipërme, pranë stafit akademik është si mbështetje dhe një personel si staf ndihmës akademik me drejtim administrativ.  Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga UV, për realizimin e

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Histori-Gjeografi” janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc. Kualifikimi i stafit akademik në këtë program studimi, për secilin vit akademik, paraqitet si vijon <b>[Anekse, tabelat 6]:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për vitin akademik <b>19-20</b>, stafi akademik efektiv (<b>PAE</b>) ka kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., dhe 7 PhD/Dr., ndërsa stafi akademik me kontratë (<b>PAK</b>) ka kualifikimin: 2 Msc.</li> <li>2. Për vitin akademik <b>18-19</b>, stafi akademik efektiv (<b>PAE</b>) ka kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 7 PhD/Dr., dhe 1 Msc., ndërsa stafi akademik me kontratë (<b>PAK</b>) ka kualifikimin: 2 Msc.</li> <li>3. Për vitin akademik <b>17-18</b>, stafi akademik efektiv (<b>PAE</b>) ka kualifikimin: 1 Prof. Dr., 1 Prof. As., 7 PhD/Dr., dhe 1 Msc., ndërsa stafi akademik me kontratë (<b>PAK</b>) ka kualifikimin: 2 Msc.</li> <li>4. Për vitin akademik <b>16-17</b>, stafi akademik efektiv (<b>PAE</b>) ka kualifikimin: 1 Prof. As., 4 Dr., dhe 2 Msc., ndërsa stafi akademik me kontratë (<b>PAK</b>) ka kualifikimin: 3 Msc.</li> </ol> <p>Referuar të dhënave të paraqitura nga UV <b>[Dokument i marrë gjatë vizitës, Tabela 12.1 e përditësuar]</b> GVJ ka mundur të llogarisë <b>ngarkesën në orë dhe % që mbulohet nga PAE dhe PAK</b> dhe konstaton se <b>raporti është në përputhje të plotë me Ligjin 80/2015 dhe Kodin e Cilësisë.</b></p> <p>Raporti i % së ngarkesës ndërmjet PAE dhe PAK, sipas viteve akademike, paraqitet si vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për vitin akademik <b>19-20</b>, stafi akademik efektiv (<b>PAE</b>) mbulon <b>87 %</b> të ngarkesës mësimore, ndërsa stafi akademik me kontratë (<b>PAK</b>) mbulon <b>13 %</b>.</li> <li>2. Për vitin akademik <b>18-19</b>, stafi akademik efektiv (<b>PAE</b>) mbulon <b>87 %</b> të ngarkesës mësimore, ndërsa stafi akademik me kontratë (<b>PAK</b>) mbulon <b>13 %</b>.</li> <li>3. Për vitin akademik <b>17-18</b>, stafi akademik efektiv (<b>PAE</b>) mbulon <b>91 %</b> të ngarkesës mësimore, ndërsa stafi akademik me kontratë (<b>PAK</b>) mbulon <b>9 %</b>.</li> <li>4. Për vitin akademik <b>16-17</b>, stafi akademik efektiv (<b>PAE</b>) mbulon <b>87 %</b> të ngarkesës mësimore, ndërsa stafi akademik me kontratë (<b>PAK</b>) mbulon <b>13 %</b>.</li> </ol> <p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur ngarkesa mësimore në orë që mbulojnë pedagogët e përfshirë në programe Histori-Gjeografisë <b>[aneksi I, tabela 4]</b>. Sipas kësaj ngarkese të dhënë, GVJ ka llogaritur <b>numrin e lëndëve dhe ngarkesën në orë</b> që mbulohet nga PAE dhe PAK. Të dhënat për <b>PAE</b> janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <b>Prof. As. A. T</b> - Në total jep 3 lëndë (2 në Bsc. Histori-Gjeografi),</li> </ol>
--	---




- 174 orë mësimore, ngarkesa sipas udhëzimit 70 (*pa orët suplementare të lejuara*);
2. **Dr. F. Sh** - Në total jep 5 lëndë (3 në Bsc. Histori-Gjeografi), 292 orë mësimore, ngarkesa sipas udhëzimit 165 (*pa orët suplementare të lejuara*);
3. **Dr. E. B** - Në total jep 5 lëndë (4 në Bsc. Histori-Gjeografi), 385 orë mësimore, ngarkesa sipas udhëzimit 165 (*pa orët suplementare të lejuara*);
4. **Dr. E. L** - Në total jep 5 lëndë (5 në Bsc Histori-Gjeografi ), 308 orë mësimore, ngarkesa sipas udhëzimit 165 (*pa orët suplementare të lejuara*);
5. **Dr. E. R** - Në total jep 5 lëndë (3 në Bsc Histori-Gjeografi ), 342 orë mësimore, ngarkesa sipas udhëzimit 165 (*pa orët suplementare të lejuara*);
6. **Dr. B. Xh** - Në total jep 4 lëndë (3 në Bsc Histori-Gjeografi ), 285 orë mësimore, ngarkesa sipas udhëzimit 165(*pa orët suplementare të lejuara*);
7. **Dr. I. Ll** - Në total jep 4 lëndë (3 në Bsc Histori-Gjeografi ), 224 orë mësimore, ngarkesa sipas udhëzimit 165 (*pa orët suplementare të lejuara*).

Ndërsa të dhënat për **PAK** janë si më poshtë:

1. **Msc. E. S** - Jep 2 lëndë në Bsc. Histori-Gjeografi, 150 orë mësimore, ngarkesa sipas udhëzimit 120;
2. **Msc. F. D** - Jep 1 lëndë në Bsc. Histori-Gjeografi, 75 orë mësimorë, ngarkesa sipas udhëzimit 120.

*Nga të dhënat e mësipërme mund të themi se ngarkesa mësimore në orë mësimore, tejkalohet vetëm nga një personel akademik efektiv dhe nga një personel akademik me kontratë. Udhëzimi i MASR, ka pëcaktuar midis të tjerash dhe ngarkesën mësimore për çdo kategori personeli akademik (që janë në krah të çdo stafi), gjithashtu ka lejuar dhe një ngarkesë prej 200 orë suplementare dhe me vendim Dekani dhe 100 orë plus. GVJ konstaton se, bazuar në Udhëzimin e MASR Nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar, Kreu II, pika 1., i cili shprehet “Në raste specifike, me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe **miratim të drejtuesit të njësisë kryesore**, personeli akademik me kohë të plotë mund të mbulojë edhe 100 orë në auditor mbi limitin 200 orë”, Institucioni nuk dispononte një vendim të drejtuesit të njësisë kryesore, për një shtesë në orë mbi 200 orët suplementare. Në dokumentacionin e sjellë nga Institucioni (komentet pas dërgimit të Draft-Raportit) GVJ-së, ju vu në dispozicion një shkresë përcjellëse e Dekanatit mbi këtë problematikë (*Shkresë Nr. 239/3 Prot., datë 23.07.2019*). Kjo shkresë ishte kërkesë për një vendimarrje në një instancë më të lartë, ndonëse bazuar në udhëzimin e sipërpërmendur, duhet të ishte vendim miratimi i titullarit të njësisë kryesore.*

*GVJ, sa më sipër, rekomandon që Institucioni të bëjë të mundur rakordimin e nevojshëm që të zbatohet në mënyrë rigoroze, ngarkesa*

	<p>mësimore sipas Udhëzimit të MASR Nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, GVJ konstaton se, <b><i>në disa raste përjashtimore, në disa prej lëndëve të zhvilluara në këtë program studimi, titullari i lëndës nuk i përket kategorisë “Profesor”,</i></b> sikurse kërkohet në ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 59, pika 3. Gjithashtu, <b><i>në disa raste, fusha e ekspertizës së pedagogut të lëndës nuk përputhet me lëndën në të cilën është angazhuar.</i></b> Këto dy pika trajtohen nga GVJ edhe në standardet II.1 dhe III.7.</p> <p>Ngarkesa mësimore e studentëve gjatë një jave varion rreth 20-25 orë mësimore në javë.</p> <p>UV, siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik mësimor me drejtimadministrativ të përshtatshëm për mirëmbajtjen e mjediseve mësimore, gjëe cila na u tha në takimet gjatë vizitës por edhe nga studentët.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<b>GVJ konstaton dhe e vlerëson si një praktikë shumë të mirë përpjekjen e Institucionit për përgatitjen e një udhëzuesi në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve [Evidenca N, Udhëzuesi].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Po në këtë drejtim, GVJ thekson se dhe në planin strategjik të UV 2018-2024, janë parashikuar disa mënyra për të zhvilluar metoda sa më efikase dhe sa më bashkëkohore në këtë drejtim ( <i>psh sistemi UMVS</i> ) <b>[Evidenca B, plani strategjik].</b>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të	Në Universitetin e Vlorës në nivel qendror është ngritur dhe funksionon struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo strukturë e

<p>mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>parashikuar në Statutin e UV, kreun VIII, me emrin Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (NJSBCVI) [Evidenca III, 1, Vendim Senati], ka në përbërjen e saj dy specialistë me drejtim ndihmës akademik me drejtim administrativ.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Kjo strukturë në varësi të Rektorit të UV, është përgjegjëse për të zhvilluar mekanizmat e monitorimit të vlerësorë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik në rang institucional. Në këtë kuadër ajo ka pasur objekt të punës së saj dhe Departmentin e Edukimit sëbashku me programin që është në proces akreditimi Bsc. në Histori-Gjeografi.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inUVajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>NJSBCVI ka realizuar në dy vitet e fundit (2017-2018 dhe 2018-2019) pyetësorët e studentit në rang institucional dhe më pas ka bërë analiza mbi këto raporte [Evidenca L, raportet e pyetësorit...]. Ky raport ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kjo e shoqëruar dhe me një analizë SWOT. Njësia realizon edhe një analizë krahasuese për pyetjet e njëjta dhe përgjigjet e studentëve në vite të ndryshme. Në këtë kuadër Senati Akademik ka miratuar procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi [Vendimi i Senatit Akademik Nr.21, datë 08.05.2018].</p> <p>NJSBCVI në punën e saj, harton dhe projekton një raport me propozime dhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe ja dërgon çdo Njësie Kryesore. Sipas procedurës së miratuar, njësia këto rekomandime i bën objekt të diskutimit me stafin e saj akademik. Pas analizës në Njësinë Kryesore, mendimet mbi këto problematika çohen në Rektorat dhe ai më pas del me një plan masash [Raporti mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vitin akademik 2018-2019]. Në këtë vlerësim nga ana e njësisë së cilësisë është dhe programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi me rekomandimet përkatëse.</p> <p><i>GVJ e vlerëson si një praktikë të mirë këtë procedurë, por do të rekomandonte që për planin e masave, të mund të ketë një konsultim paraprak edhe me studentë.</i></p> <p><i>Rekomandim i GVJ-së është dhe ngritja sa më shpejtë e komisionit të përhershëm të sigurimit të cilësisë, i cili është dhe detyrim ligjor. GVJ rekomandon gjithashtu që Institucioni, të mund të bëjë një marrëveshje me AADF (Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit) për të bërë të mundur implementimin e marrëveshjes Clean Score, e cila do të ndihmojë në rritjen e përmirësimit të sistemit të sigurimit të cilësisë.</i></p> <p>Në RVB, por edhe në takimet që zhvilluam në institucion na u tha që për stafin ndihmës akademik po përgatitet një pyetësor për të vlerësuar cilësinë, po që për momentin është në fazë testimi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	




**Standardi III.2**  
**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra UVsit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në programin e studimit Bsc. Histori-Gjeografi, sipas dokumentacionit në DVV, RVB, por edhe në takimet që GVJ zhvilloi në institucion, konstaton se format e mësimdhënies qëpërdoren në procesin mësimor janëmetodat standarde si leksione, seminare, praktika në terren, detyrat e kursit dhe tema tëdiplomave <b>[rregullore e programit të studimit]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Stafi akademik, në këtë program studimi por edhe për programet e tjera të DE, përdor metoda alternative gjatë mësimdhënies si prezantime në poëerpoint, mënyra audiovizive, biseda interaktive, etj.</p> <p><i>Në programin e studimit nuk kanë pasur studentë me aftësi ndryshe, por GVJ rekomandon që edhe për këtë kategori të parashikohet në rregullore mënyra se si do të veprohet <b>[rregullore e programit të studimit ka parashikuar vetëm për studentët e huaj]</b>.</i></p> <p>Në takimet me stafin akademik na u bë me dije se ata i marrin parasysh kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për zhvillimin më efektiv dhe cilësor të mësimin, leksioneve apo seminareve, për ti bërë ato më efektive dhe tërheqëse.</p> <p>UV, u siguron stafit akademik logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor duke bërë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>UV, u siguron stafit akademik logjistikën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor duke bërë të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit të tyre profesional në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Ashtu siç u theksua edhe më lart, Institucioni me anë të NJSBCVI, vlerëson në mënyre periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të vlerësimit <b>[Statuti neni 34, rregullorja e FSHH neni 22]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Personeli akademik përdor projektorët për prezantime powerpoint për dhënieve e leksioneve dhe prezantimeve.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Sipas rregullores, gjatë procesit mësimor dhe praktikës apo punimit të temës së diplomës, studentët asistohen nga pedagogët e tyre si në ndërtimin e strukturës së diplomës, zgjedhjen e temës apo hartimin e saj duke gjetur tema të lidhura me problematika kryesore të Historisë apo Gjeografisë, sidomos në fushën e mësimdhënies.</p> <p><i>GVJ nuk identifikoi forma dhe metoda të tjera të përdorimit të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve që ndërthuren me teknologjinë.</i></p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkuaajnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			<b>X</b>	

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.	Programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi e zhvillon veprimtarinë e tij në ambientet që i përkasin Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit të Vlorës. Hapësirat në këtë njësi kryesore janë të mjaftueshme dhe të përmirësuara ndjeshëm këto vitet e fundit. Në FSHH ka 13 salla për leksione (935m <sup>2</sup> ) 5 salla për seminare ( <i>Institucioni ka siguruar hapësira të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor</i> ). Programi ka gjithsej 54 studentë në të treja vitet dhe ky numër u siguron atyre kushte të mira mësimdhënie [ <b>Aneksi I, tabela 16, Takimi me sekretarinë mësimore</b> ]. Nga vizita në institucion vumë re se sallat ishin të pastra dhe të mirëmbajtura dhe të pajisura me ndriçimin e duhur. Për pastrimin dhe mirëmbajtjen në FSHH ka një personel shërbimi, i cili përbëhet nga 4 persona [ <b>RVB fq 28</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Ambientet ku zhvillohet procesi mësimor kanë logjistikë nevojshme, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me projektorë për zhvillimin e mësimit [ <b>Vizitë në ambiente</b> ].
<b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.	Për të krijuar sa më shumë kushte në procesin e mësimdhënies, Senati Akademik me vendim Nr. 101, datë 06.12.2017, <i>ka miratuar krijimin dhe funksionimin e platformës digjitale në UV</i> . Institucioni ka dhe një sistem menaxhimi të informacionit mësimor (UVMS) i cili lehtëson shumë punën e stafit akademik por edhe të studentëve. Për të lehtësuar sidomos punën e studentëve, Institucioni ka përgatitur dhe një udhëzues praktik. Institucioni kishte wifi dhe lidhje interneti fiks në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve të FSHH.
<b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Në lidhje me literaturën, e cila sipas rregullores është e përcaktuar në fund të çdo syllabusi, studenti gjen informacion lidhur me literaturën që mund të konsultojnë në gjuhën shqipe apo të huaj që i përgjigjet temave të programit mësimor [ <b>Evidenca I.6, syllabuset e lëndëve</b> ].
<b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.	<i>GVJ shpreh shqetësimin që është shprehur dhe në RVB, por sidomos e theksuar në takimet me studentë për mungesa në disa prej teksteve bazë gjë që u pa dhe në vizitën në bibliotekën e FSHH, ku u konstatua një numër shumë i pakët i librave për këtë program studimi.</i> <i>GVJ rekomandon që Institucioni të mund të vërë në dispozicion fonde që tekstet kryesore që mungojnë, të mund të blihen dhe të jenë të aksesueshme në bibliotekën e FSHH.</i>
<b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Institucioni i siguron studentëve dhe stafit akademik mundësi aksesimi në librarinë online si burim informacioni sipas programit të studimit që
<b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të UVsit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	



<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>ata frekuentojnë. Kjo sipasojë e mbështetjes nga ana e MASR me shërbimin e bibliotekës online “ULIBRARY”. Platforma është re dhe institucioni për ti ardhur në ndihmë kryesisht studentëve, ka vënë në dispozicion edhe manualin e aksesit ne bibliotekën online <b>[manuali nga RASH]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet UV ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Institucioni siguron ambiente të mjaftueshme në funksion të programit mësimor si laboratorin e gjuhëve të huaj (ku Bsc. Histori-Gjeografi zhvillon një pjesë të mësimin), ndërsa si DE kishte dhe një laborator për pedagogjinë e specializuar, një laborator për edukimin artistik, ambientet e bibliotekës etj, por në takimet me stafin dhe studentët na u tha se mungon një laborator specifik për informatikën <b>[të dhëna për infrastrukturën]</b>.</p> <p><b>GVJ konstaton se UV ka një platformë elektronike mjaft të mirë (UVMS) me anë të së cilës, realizohet komunikimi i stafit akademik me studentët për çdo lëndë të planit mësimor të programeve përkatëse.</b> Çdo personel akademik ka llogarinëe tij në këtë platformë ashtu dhe mundësia që kanë studentët për të aksesuar dokumentacion nga kjo platformë. Në këtë hapësirë studentët mund të marrin: leksionet, syllabusin, etj, gjithashtu aty marrin dhe dokumentacion tjetër të nevojshëm (psh. fatura të ndryshme, etj).</p> <p>Në lidhje me infrastrukturën online, Institucioni ka faqen e tij zyrtare, në të cilën publikohen informacione dhe njoftime të ndryshme.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit kemi të përcaktuar se temat e diplomës zgjidhen nga studentët në konsultim me pedagogët e tyre në mënyrë që temat e tyre të jenë lidhur me problematikat aktuale të Historisë dhe Gjeografisë, kryesisht në fushën e mësimdhënies. Sipas rregullores neni 19, studentët duhet të kenë një notë mesatare mbi 9, që të mund të marrin temë diplome. Sipas rregullores, drejtuesit e temave miratohen nga Departamenti, ndërsa mbrojtja bëhet e hapur dhe sipas procedurave të parashikura në rregullore <b>[Evidenca I. 5]</b> (do të sqarohet edhe më poshtë që deri tani nuk kemi asnjë rast të mbrojtjes me temë).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Nga raporti i mësipërm kur kemi folur për sigurimin e brendshëm të cilësisë kemi theksuar se njësia përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional është NJSBCVI <b>[ngritur me Vendim Senatit Nr. 21, datë 08.05.2018]</b>.</p> <p>Kjo njësi ka miratuar procedurën e analizës dhe vlerësimit të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo</p>




<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>programi studimi dhe mbi bazë e saj, kryen aktivitetin në promovimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies <b>[procedura dhe miratimi i saj me Vendim Senati Nr. 21, datë 08.05.2018]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies në takimet në institucion, na u theksua dhe përvoja shumë e mirë e fituar në kuadrin e Sondazhit Kombëtar të Studentëve (<i>sondazh i kryer nga ASCAL</i>).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni e ka vlerësuar shumë të rëndësishëm edhe eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies dhe për këtëka ngritur Qendrën Studimore Ndërdisciplinore për Zhvillimin Rajonal <b>[Evidenca N]</b>. Në udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit, shohim se një nga qëllimet e saj kryesore është dhe mbështetja eksperimentale bashkëkohore në fushën e mësimdhënies.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p><b>GVJ e vlerëson këtë akt që institucioni ka ndërmarrë në këtë fushë duke e institucionalizuar atë. Pavarësisht përpjekjeve që kanë bërë drejtuesit e institucionit, fakultetit dhe departamentit, bazuar në diskutimet e kryera me ta rezulton se ka ende punë për të rritur vetë ndërgjegjësimin e personelit akademik në lidhje me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>GVJ identifikoi se Institucioni mbështet angazhimin e personelit akademik në fushën e kërkimit shkencor duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në aktivitete shkencore, konferenca apo rimbursim të shpenzimeve të udhëtimit, realizimit të konferencave të përbashkëta me IAL brenda vendit apo jashtë, mbështetje për realizimin e botimeve në buletin shkencor të fakultetit apo revista të tjera, brenda dhe jashtë vendit <b>[Aneksi I, tabela 19]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Disa të dhëna mbi kërkimin paraqiten si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i botimeve nga PAE: 75;</li> <li>- Projekte të fituara si Njësia kryesore/bazë: nuk ka;</li> <li>- Numri i projekteve të zbatuara nga DE: 2;</li> <li>- Numri i aktiviteteve shkencore organizuar nga Njësia kryesore/bazë /UV për programin e studimit: Konferenca 22; Monografi 2;</li> <li>- Numri i pjesëmarrësëve në aktivitete shkencore: 382;</li> <li>- Një çmim ekselence për burimet njerëzore në kërkim, dhënë nga Komisioni Evropian.</li> </ul> <p><b>GVJ thekson se duhet bërë një punë më e madhe në këtë drejtim dhe sugjerojmë se duhet në të ardhmen të ketë të paktën një aktivitet kërkimor shkencor një herë në vit në fushën e programit të studimit që po akreditohet.</b></p> <p>Institucioni i ka siguruar infrastrukturën fizike të nevojshme departamentit për trajnim të stafit akademik dhe për zbatimin e metodave inovative në mësimdhënie në bashkëpunim me strukturat drejtuese dhe departamentet e tjera te FSHH.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>




standardit	përbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

**Standardi III.5**  
**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Institucioni zotëron një rregullore të përgjithshme të UV (<i>për të cilën më lart kemi shprehur mendime si GVJ</i>), një rregullore të FSHH, një rregullore të DE dhe një rregullore të veçantë të programit të studimit, në të gjitha këto rregullore janë të shprehura qartë kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale organizimin e mbrojtjes së diplomave. Studentët njihen me këto rregullore në ditët e para të shkollimit të tyre, orientohen nga koordinatori i programit të studimit dhe këto rregullore (<i>një pjesë</i>) janë dhe në webin zyrtar të UV [<b>Rregullore e UV, FSHH, DE dhe rregullore e programit të studimit</b>].</p> <p>Studentët informohen nga titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në fillim të çdo viti akademik apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloren e funksionimit të FSHH si dhe rregulloren e programit të studimit [<b>plani mësimor, dosja e programit</b>].</p> <p>Testimi i dijeve dhe aftësive profesionale bëhet me shkrim, gojë ose me temë diplome sipas rregulloreve të funksionimit të programit. Mënyra e procedura e vlerësimit, ju komunikohet studentëve në fillim të procesit mësimor [<b>rregullore e programit të studimit</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>				
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>				
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Standardi III.6**  
**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Testimi i dijeve të studentëve në këtë program studimi, realizohet në dy sezone “Dimër”, “Verë” dhe në përfundim të programit mësimor. Sipas parashikimeve që janë në syllabuset e depozituara, ka dhe teste të ndërmjetme. Ky testim në tre periudha kohore u pa nga GVJ dhe në kalendarin e provimeve të vitit akademik.</p> <p><i>Nuk përdoren sisteme elektronike të testimit në këtë program studimi, për këtë arsye edhe më lart kemi rekomanduar marrëveshjen me AADF dhe realizimin e testeve elektronike me anë të projektit Clean Score.</i></p> <p>Provimi zhvillohet nga dy pedagogë, njëri prej të cilëve është pedagogu i lëndës. Ndërsa bazuar në rregulloren e programit të studimit provimi i</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga</p>	

komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	diplomës realizohet nga një komision prej 5 vetash. Ky komision përcakohet nga DE dhe në kuadrin e transparencës, bëhen publike dy javë para testimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi i dijeve në këtë program studimi kur ai realizohet me shkrim nuk bëhet në mënyrë anonime apo me sekretim <b>[rregullore e programit të studimit]</b> . Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë dhe komisionit të provimit. <b>Sipas GVJ, ndonëse institucioni është korrekt në zbatimin e rregullores, në të ardhmen mund të vendosi në rregullore sekretimin si një nga format e sigurimit të cilësisë.</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pas përfundimit të provimit, rezultatet shfaqen në sistemin UVMS jo më larg se 48 orë nga dita e korrigjimit, kjo konform rregullores së programit të studimit. Studentët kanë të drejtën e rishikimit të tezës së korrigjuar dhe bazuar në rregulloren e UV, gjithashtu kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin.			
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	Në takimet me studentët nuk na u paraqitën raste të ankimeve, ata u shprehën të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real, gjithësesi ata janë dijeni të rregullores dhe të drejtës së tyre për ankimim <b>[Takimi me studentët]</b> .			
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.				
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.				
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjeUV dokumentohet dhe arkivohet.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.7</b> <b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi, është i organizuar sipas përcaktimeve të akteve nënligjore në fuqi dhe i aftë që të thellojë dhe të zhvillojë aftësitë profesionale në dy fusha, histori dhe gjeografi. Programi i studimit Bsc. Histori-Gjeografi zhvillohet në 3 vite

<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>akademike me 6 semestra dhe ka 180 ECTS në total. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore = 50 minuta (<i>në praktikë ishte 50, në rregulloren e studimit 60</i>) 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit. Procesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p><b>[Rregullore e programit të studimit].</b> Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e objektivave si dhe pajisjen e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe ndërveprimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Plani mësimor nuk ka lëndë/module të teknologjisë së informacionit por nga vizita në institucion na u tha që këtë lëndë do ti zhvillojnë në ciklet pasardhëse.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Dijet e marra, aftësitë dhe kompetencat e përfituara gjatë realizimit të programit të studimit vlerësohen në përfundimin e lëndëve përkatëse me sistemin e notave ku nota 5 është nota minimale kaluese dhe 10 është nota maksimale <b>[Rregullorja e programit të studimit].</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Në fillim të çdo viti akademik stafi akademik paraqet në Departament syllabusin e lëndës përkatëse në të cilin janë reflektuar përveç te tjerave dhe vërejtje apo sugjerime të studentëve. Në takimet në institucion na u theksua (<i>pasi si mendim është dhe në RVB</i>) që stafi ka marrë sugjerime shumë të vlefshme nga studentët që tashmë janë në tregun e punës. Në Dhjetor të vitit të kaluar, UV ka organizuar një workshop me temë “<i>Studentët dhe tregu i punës</i>” <b>[informacion që gjendet edhe në webin zyrtar të UV]</b> dhe sipas drejtuesve dhe stafit ishte shumë i vlefshëm.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Në përfundim të modulit/lëndës, pedagogu organizon një përmbledhje të temave dhe çështjeve të diskutuara dhe orienton studentët për provimin përfundimtar, mënyrën e organizimit të tij dhe vlerësimit të dijeve <b>[Takimi me studentët].</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Gjatë vitit akademik, DE ka organizuar leksione të hapura, por jo në programin që po akreditohet. Në planin strategjik të njësisë bazë, në të ardhmen janë parashikuar dhe leksione të hapura në fushën e Historisë dhe të Gjeografisë.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Në programin Bsc. në “Histori-Gjeografi” janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Pjesa më e madhe e stafit akademik (<i>sidomos në lëndët karakterizuese të kategorisë B, ku është dhe përqëndrimi më i madh i lëndëve</i>), janë specialistë të mirëfilltë të disiplinave të përkatëse (<i>pothuajse të gjithë Doktor</i>).</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit në bazë të legjisllacionit në fuqi ka një ndërthurje midis punës në auditor dhe punës individuale të studentit jashtë auditorit. Institucioni mbështet stafin dhe studentët e tij në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Një nga këto mbështetje për studentët është dhe mundësia e tyre për të publikuar në <i>Buletinin e studentëve të FSHH në vitin 2018.</i></p>

	<p>Stafi akademik ka marrë pjesë në disa aktivitete shkencore ndërkombëtare dhe bazuar në këtë përvojë por edhe në traditën e UV, format e mësimdhënes janë të përafërta apo gati të njëjta me institucione apo programe si motra [tabela e mobilitetit III.6].</p> <p>Në RVB, por edhe në takime në institucion, na u tha se stafi akoma nuk është shumë kërkues apo i përfshirë sidomos në Erasmus+. <i>GVJ rekomandon që në të ardhmen stafi të mund të rrisë numrin e shkëmbimeve në kuadrin e projekteve Erasmus+ apo dhe projekte të tjera.</i></p> <p><i>Një pikë e dobët është dhe mungesa e interesit të studentëve për tu përfshirë në mobilitete [RVB dhe takimi me studentët].</i> Arsyeja që na u tha është mosnjohja e gjuhës angleze, si dhe largimi nga familja.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Për realizimin e provimit final ose diplomës, DE vepron në përputhje me rregulloren e programit të studimit Bsc. “Histori-Gjeografi”, neni 14 dhe 15. Në takimet me studentët na u konfirmua që kishin dijeni për procedurën e provimit final ose diplomës për ata që e kishin mesataren mbi 9, informacionin e kishin marrë në takimet me stafin dhe me sekretarinë [Rregullorja e programit të studimit, takimi me studentët].
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	DE, në zbatim të rregullores së programit të studimit, ka struktura që asistojnë studentët për diplomën ose provimin final. Në lidhje me mbrojtjen e diplomës, sipas rregullores, përgjegjës është stafi akademik që ka marrë përsipër udhëheqjen e studentit dhe është ai që e orienton mbi procedurën, mbi materialet, etj. Në DE sipas rregullores, kryhet dhe provimi final për ata studentë që e kanë mesataren poshtë notës 9. Studentëve u vihet në dispozicion një set pyetjesh për provimin final për programin e Historisë dhe Gjeografisë dhe mbi bazën e ketij seti zhvillohet dhe provimi. Studentët kishin informacion mbi të dyja procedurat e parashikura në rregullore [Banka e pyetjeve të formimit për programin Bachelor në Histori-Gjeografi, Takimi me studentët].
<b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Komisioni për provimin e diplomës përbëhet nga 5 persona, të cilët pasi miratohen paraprakisht nga DE, dërgohen nga përgjegjësi i DE për miratimin zyrtar te Dekani i FSHH. Dekani miraton komisionin por edhe kryetarin e ketij komisioni. Provimi bëhet me gojë ose mbrojtje teme. Provimi me gojë siç e kemi thënë dhe më lart, bazohet në një set pyetjesh që bazohen në njohuritë që ata kanë marrë gjatë tre viteve
<b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e	

tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	akademike dhe të ndara gati në mënyrë të barabartë midis Historisë dhe Gjeografisë. Pyetjet bëhen publike gati dy muaj para zhvillimit të provimit [3.13 Banka e pyetjeve të formimit për programin Bachelor në Histori-Gjeografi].			
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Nga konstatimi i GVJ, e shprehur dhe në RVB, për periudhën në të cilën akreditohet programi nuk kishte asnjë student që të kishte zhvilluar temë diplome, të gjithë kishin kryer mbrojtje me gojë, bazuar në setin e pyetjeve që kemi përmendur më sipër.			
<b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në fund të provimit studentët vlerësohen për njohuritë e tyre me notë. Nota është një mesatare e thjeshtë aritmetike e bashkimit të vlerësimit të çdo anëtari të komisionit [Rregullorja e programit të studimit, takimi me studentë, procedura e diplomit në DE].			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, bazuar në legjislacionin në fuqi, por edhe në rregulloren e UV, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MASR dhe e përgatitur sipas kërkesave të hapësirës europiane të arsimit të lartë. Diploma është një dokument zyrtar i Universitetit të Vlorës.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Programi i plotë i tre viteve akademike, sipas rregullores, u jepet vetëm atyre studentëve që e kërkojnë zyrtarisht. Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. Sekretaritë, informacionin për studentin e kanë të ruajtur në tre regjistra: 1. Regjistrin themeltar të studentëve; 2. Regjistrin e arritjeve akademike; 3. Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave. GVJ bëri një kontroll të rastësishëm për disa studentë, krahasimi midis notës së marrë në procesverbal dhe notës së hedhur në regjistrin e arritjeve akademike dhe rezultoi korrekt.  Në çdo rast që mund të kërkohet informacion nga studenti, sekretaria i kishte gati dhe duke zbatuar procedurën dhe rregulloren, i jepte ato. [takimi në institucion me sekretarinë mësimore].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe</b>

përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni mbledh të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit nëpërmjet Sektorit të Burimeve Njerëzore. Nga verifikimi i dosjeve të rastësishme nga GVJ u konstatua prania e dokumenteve bazë (CV, diploma, listë notash, librezë pune, etj). Dokumente që vërtetojnë ecurinë akademike të stafit (certifikata trajnimesh apo konferencash që ndjek stafi çdo vit, fotokopje të botimeve të përvitshme) administrohen në Sektorin e Kërkimit Shkencor dhe Publikimeve (<b>Shkresa Nr. 131/1 Prot., datë 16.04.2020</b>).</p> <p>Institucioni në rregulloren e Universitetit ka përcaktuar procedurat e rekrutimit të personelit akademik, të cilat janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 si dhe në përputhje me statutin e Institucionit [<b>Statuti i UV, neni 5</b>]. Në statutin e institucionit përcaktohet se punësimi i personelit akademik dhe ndihmës akademik bëhet me konkurs [<b>Statuti i UV, kreu V, neni 51, pika 1</b>]. Pas publikimit të thirrjes në website të Universitetit, Rektori krijon komision ad-hoc për rekrutimin e personelit. Komisioni ad-hoc rendit kandidatet sipas pikëve të grumbulluara dhe ia përcjell Rektorit për vendim përfundimtar. Ankesat në lidhje me vlerësimin e kandidatëve dhe zbatimin e procedurave nga komisioni ad-hoc paraqiten tek Rektori brenda pesë ditësh [<b>Statuti i UV, Kreu V, neni 51, pika 1,2,3,4,5</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni harton procedura dhe kriteret në përputhje me Ligjin 80/2015. Sipas këtij ligji, personeli akademik në IAL, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në a) Profesor, b) Lektor, c) Asistent lektor [<b>Kreu VI, neni 59, pika 2</b>]. Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës [<b>Ligji 80/2015, neni 59, pika 6</b>]. Kriteret e punësimit të personelit përcaktohen nga njësi bazë, miratohen nga Rektori dhe publikohen në website të universitetit [<b>Statuti i UV, kreu V, neni 51, pika 2</b>]. Sipas rregullores së UV, institucioni nëpërmjet njësisë bazë rast pas rasti përcakton kriteret specifike krahas kriterëve të përgjithshme. Thirrja dhe kriteret bëhen publike dy javë përpara dhe publikohen në faqen online të Universitetit [<b>Rregullore e përgjithshme UV</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Institucioni harton procedura dhe kriteret në përputhje me Ligjin 80/2015. Sipas këtij ligji, personeli akademik në IAL, sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet në a) Profesor, b) Lektor, c) Asistent lektor [<b>Kreu VI, neni 59, pika 2</b>]. Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës [<b>Ligji 80/2015, neni 59, pika 6</b>]. Kriteret e punësimit të personelit përcaktohen nga njësi bazë, miratohen nga Rektori dhe publikohen në website të universitetit [<b>Statuti i UV, kreu V, neni 51, pika 2</b>]. Sipas rregullores së UV, institucioni nëpërmjet njësisë bazë rast pas rasti përcakton kriteret specifike krahas kriterëve të përgjithshme. Thirrja dhe kriteret bëhen publike dy javë përpara dhe publikohen në faqen online të Universitetit [<b>Rregullore e përgjithshme UV</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Struktura ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura për garantimin e stafit të kualifikuar. Sikurse është përmendur edhe në standardin III.7, jo në të gjitha rastet stafi i përzgjedhur ka përputhje me kualifikimit të tij dhe moduli ose lëndës që zhvillon. Nga kontakti me stafin akademik si dhe nga verifikimi i CV, <i>jo gjithnjë ka përputhje të kualifikimit specifik dhe lëndëve që zhvillojnë</i>. Në takimin me stafin akademik kjo u argumentua se ka ardhur si pasojë e mos paraqitjes së kandidatëve me kualifikim specifik [<b>CV, Takimi me stafin akademik</b>].</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>



standardit				<b>X</b>
------------	--	--	--	----------

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Institucioni ka krijuar një mjedis fizik të përshtatshëm për stafin akademik dhe jo akademik si dhe mundësi e lehtësi për realizimin e detyrave të stafit. Kjo u konstatua nga takimi me Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjës të DE si dhe nga takimi me stafin akademik. Ekziston një frymë mbështetjeje dhe nxitjeje për stafin akademik nga ana e drejtuesve të institucionit si dhe një frymë bashkëpunimi mes vetë stafit për barazpeshimin e ndarjes së ngarkesës mësimore dhe detyrave të tjera administrative <b>[Vizitë e GVJ në ambiente]</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga takimet me përfaqësuesit e zyrës së karrierës, projekteve dhe me vetë stafin konstatuam se institucioni angazhohet maksimalisht për kualifikimin e vazhdueshëm të stafit. Dy vitet e fundit, katër anëtarë të stafit akademik janë doktoruar në histori dhe gjeografi. Institucioni mbështet financiarisht mobilitetet e stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore çdo vit (rreth 50 të tillë në total). Institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të programit Erasmus dhe Mevlana për mobilitete të stafit akademik dhe të studentëve <b>[Takimi me Dekanin, Përgjegjës të DE dhe stafin akademik]</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni ka organizuar një trajnim për stafin akademik për përdorimin e programit Moodle dhe është në proces organizimi për trajnimin e stafit për njohjen e programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja. Ndonëse nuk ka laborator për GIS (hartografi dixhitale), drejtuesit e departamentit dhe fakultetit nxisin dhe stimulojnë futjen e metodologjive dhe teknologjive të reja. Kjo e konfirmuar edhe nga vetë stafi akademik si dhe nga udhëzuesi Nr.1, dt. 13.01.2020 mbi zhvillimin e metodave inovative në mësimdhënie <b>[Udhëzuesi nr.1, dt. 13.01.2020]</b> .
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Institucioni vë në dispozicion të përmbushjes së objektivave të programit bachelor stafin akademik dhe stafin ndihmës akademik. Nga verifikimi i ngarkesës mësimore të secilit si dhe nga takimi me stafin akademik, GVJ konstatoi se stafi akademik është i angazhuar pothuajse tërësisht në mësimdhënie duke patur edhe mbinormë të konsiderueshme, ku në disa raste mbinorma arrin dhe tejkalon normën e lejuar sipas titullit ( <b>Shiko Standardi II.5 më lart</b> ). Kjo mbingarkesë në procesin mësimor nuk i jep kohë të mjaftueshme stafit akademik për tu angazhuar me kërkim shkencor dhe projekte. <i>GVJ sugjeron lehtësimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik në funksion të shtimit të kohës fizike për punë shkencore dhe projekte.</i> Në mbështetje




	të stafit akademik është dhe një personel si staf ndihmës akademik me drejtim administrativ [ <b>Takimi me stafin dhe aneksi I, tabela 4</b> ].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Institucioni ka siguruar një mjedis fizik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e procesit mësimor. Nga vizita në godinën B ku zhvillohet mësimi, GVJ konstatoi salla leksionesh dhe seminaresh komode, me hapësira të mjaftueshme, dritë dhe banka të reja. Brenda godinës ndodhet edhe biblioteka e cila ka hapësirë dhe është e pajisur me kompjutera. Kushtet higjieno-sanitare janë të mira [ <b>Vizitë e GVJ në ambiente</b> ]. <i>Nga takimi me studentët u konstatua se ngrohja lë akoma për të dëshiruar</i> [ <b>Takim i GVJ me studentët</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në sallat e leksioneve dhe seminareve GVJ konstatoi se janë të pajisura me paisje (projektor, laptop portativ) pjesa dërrmuese e tyre. Biblioteka është e pajisur edhe me kompjutera në dispozicion të studentëve [ <b>Vizitë e GVJ në ambiente</b> ].  Sallat e leksioneve dhe të seminareve përmbajnë pajisje projektor dhe laptop (portativ) dhe harta, në funksion të kërkesave të moduleve. <i>Mungon një laborator IT me GIS software për krijimin e hartave dixhitale.</i> Kjo kërkesë u theksua nga pedagogët dhe studentët [ <b>Takim i GVJ me stafin akademik dhe me studentët</b> ].
<b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Institucioni nuk ka një laborator të teknologjisë së informacionit të pajisur me programe profesionale (ArcGIS-hartografi digjitale). Nga takimi me studentët por edhe me stafin akademik u ngrit çështja e pajisjes me një laborator me PC për të punuar ose studiuar online si dhe me GIS software për realizimin e hartave digjitale [ <b>Takim i GVJ me stafin akademik dhe me studentët</b> ].
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.	Institucioni garanton me mjediset dhe kapacitetet e tij si dhe me marrëveshjet bashkëpunuese me Drejtoritë e muzeve dhe monumenteve të Qarkut Vlorë për zhvillimin e praktikës në terren, ku studentët shoqërohen gjithnjë nga pedagogë të DE, seksioni Histori-Gjeografi. Kjo u vërtetua nga verifikimi i marrëveshjeve në website [ <a href="https://univlori.edu.al/sektori-projekteve/marreveshje-nder-institucionale/">https://univlori.edu.al/sektori-projekteve/marreveshje-nder-institucionale/</a> ] [ <b>RVB standardi 1.5, kriteri 2</b> ] si dhe nga takimi me stafin dhe studentët. <i>Këta të fundit kërkonin vizita në terren edhe në vitin e tretë si dhe kohëzgjatjen e tyre</i> [ <b>Takimi me stafin dhe studentët</b> ].
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme	

dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.				
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Intitucioni ka tre biblioteka në dispozicion të studentëve. Bibliotekën qëndrore në godinën A, sallën e bibliotekës në godinën B të Fakultetit të Shkencave Humane si dhe bibliotekën në godinën C. Bibliotekën në godinën B studentët e programit mësimor Histori-Gjeografi mund ta shfrytëzojnë rregullisht gjatë javës. Ambienti i bibliotekës është komod dhe i përshtatshëm për studim për studentët <b>[Vizita e GVJ në bibliotekën në godinën B të FSHH].</b>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<i>Nga vizita e GVJ u vu re mungesë e teksteve universitare bazë të gjeografisë kryesisht, por edhe të historisë, në dispozicion të studentëve. Kjo mungesë u konstatua edhe nga vetë studentët të cilët tekstet universitare i marrin me fotokopje të sugjeruara nga pedagogët e lëndëve. Nga verifikimi i librave në bibliotekë, GVJ vuri re mungesën e literaturës së gjeografisë nga autorë të huaj dhe të autorëve shqiptarë të viteve të fundit. Mungesa e teksteve bazë të gjeografisë si dhe e literaturës së huaj të kufizuar tregon se fondet për blerje librash nuk janë të mjaftueshme [Vizita e GVJ në bibliotekë].</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni disponon bibliotekë online, të cilën studentët mund ta aksesojnë në faqen e Universitetit, tek Studentët/Biblioteka online/ulibrary. Studentët mund të aksesojnë pa pagesë Ulibrary duke u identifikuar si student të UV dhe duke ndjekur udhëzimet përkatëse. Në Ulibrary ndodhet një listë me numrin e librave dhe revistave që studentët mund të aksesojnë <b>[Ulibrary/List available at <a href="https://ulibrary.rash.al/lista.pdf">https://ulibrary.rash.al/lista.pdf</a>].</b> Nga takimi me studentët GVJ u informua se studentët ende nuk e përdorin ULibrary <b>[Takimi me studentët].</b>
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Nga vizita në bibliotekë, GVJ konstatoi se ka kompjutera me akses interneti të vëna në dispozicion të studentëve <b>[Vizita e GVJ në bibliotekë].</b>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni ndjek një strategji të pasurimit të zërave të bibliotekës çdo vit. Biblioteka, në bashkëpunim me Përgjegjësin e DE dhe stafin akademik, bën pasurimin e saj me tituj librash. Sipas drejtuesit të Bibliotekës mesatarisht çdo vit blihen rreth 35 tituj të rinj, përveç
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të	

<p>studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>librave të dhuruar. Për plotësimin e mungesës së librave (të përmendur më lart) <i>institucioni nevojitet të shtojë fondet për blerje të teksteve bazë dhe literaturës bashkëkohore në ndihmë të studentëve të këtij programi [Informacion dhe rregullore e bibliotekës, Vizitë e GVJ në bibliotekë].</i></p> <p>Biblioteka është në dispozicion të studentëve gjatë gjithë vitit përfshirë edhe kohën e sezonit të provimeve. Studentët konfirmuan përdorimin e bibliotekës në çdo kohë dhe nuk paraqiten probleme për aksesimin e saj. Biblioteka në Godinën B të FSHH është e hapur 8-16, ndërsa biblioteka qëndrore është e hapur 08-20 [Vizitë e GVJ në Bibliotekën e godinës B].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi IV.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon sistem të menaxhimit të informacionit në lidhje me studentët. Sistemi i menaxhimit operohet nga sekretaria mësimore, e cila disponon regjistrat themeltar, procesverbalet e çdo provimi dhe regjistrin e diplomave [Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore]. Përveç regjistrave, institucioni ofron edhe platformën dixhitale UVMS për informimin e studentëve [https://uvms.univlora.edu.al/user/login].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit lidhur me dokumentacionin dhe aktivitetin e stafit akademik, jo akademik dhe administrativ realizohet nëpërmjet zyrës së Burimeve njerëzore dhe protokoll arkivës. Kjo zyrë përmban gjithë informacionin në dosjet përkatëse [Vizitë e GVJ në Zyrën e Burimeve njerëzore].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar për informacione dhe dokumente për studentët dhe stafin akademik. Kjo realizohet nëpërmjet platformës dixhitale UVMS [https://uvms.univlora.edu.al/user/login].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Platforma dixhitale UVMS mundëson forma të komunikimit interaktiv të stafit dhe studentëve lidhur me vlerësimin e tyre për performancën akademike dhe etike. Stafi akademik komunikon rezultatet tek studentët nëpërmjet kësaj platforme. Platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve për çështje mësimore institucioni nuk disponon [https://uvms.univlora.edu.al/user/login].</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit</p>	

garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Aktualisht sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët për rezultatet e provimeve si dhe rezultatet e pyetësorëve [ <a href="https://uvms.univlora.edu.al/user/login">https://uvms.univlora.edu.al/user/login</a> ].			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit të Universitetit. Materialet janë në gjuhën shqipe. Ekziston edhe gjuha angleze, por vetëm titujt kryesor janë në gjuhën angleze. Nga verifikimi i website të UV, GVJ vuri re se materialet në brendësi janë në gjuhën shqipe. Syllabuset janë vetëm në gjuhën shqipe. <i>GVJ sugjeron që Institucioni të plotësojë përkthimin e materialeve dhe zërave të ndryshëm në gjuhën angleze</i> [ <a href="https://univlora.edu.al/en/doktoratat/">https://univlora.edu.al/en/doktoratat/</a> ].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.6</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni, nëpërmjet strukturës përgjegjëse dhe në bashkëpunim me secilin departament, harton një raport financiar mbi nevojat dhe kostot financiare të secilit program studimi. Tarifat e studentëve publikohen online në përputhje me ligjet dhe udhëzimet në fuqi. Institucioni mbulon koston e realizimit të programit nga të ardhurat shtetërore si dhe nga të ardhurat që siguron vetë. <i>GVJ nuk konstatoi një raport të kostove të programit të studimit, përveç tarifave të studentit [Evidenca J].</i> IAL shprehet se, duke filluar nga 2021, mendohet që të fillojë detajimi në nivel njësie bazë i buxhetit, me qëllim përlllogaritjen e koston së studentit për program studimi [Shkresa Nr. 131/1 Prot., datë 16.04.2020].  <i>Institucioni nuk disponon një plan financimi të programit të studimit Histori-Gjeografi në veçanti, por institucioni në planin financiar të tij parashikon shpenzimet për stafin akademik, kostot operative, kostot për pasurimin e bibliotekës [<a href="https://univlora.edu.al/raporti-financiar/">https://univlora.edu.al/raporti-financiar/</a>].</i> Nga takimi me stafin akademik, GVJ konstatoi se anëtarë të DE kanë marrë pjesë si ekspertë në disa projekte dhe në disa raste DE është përfshirë si partner në projekte të vogla [Takimi i GVJ me stafin akademik]. <i>GVJ nuk evidentoi grante vendase apo të huaja për projekte në funksion të realizimit të programit të studimit.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin	Institucioni kryen çdo vit auditim të brendshëm dhe të jashtëm. Që nga viti 2019 funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm të Universitetit. [Vendimi i Senatit Akademik Nr. 8, datë 14.02.2019]. Kjo njësi

<p>financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>kryen auditime periodike dhe harton raportin vjetor të auditimit të brendshëm. Në raportin financiar të vitit 2018-2019 jepen të dhëna të hollësishme për tarifat e shkollimit dhe ndarjen e burimeve financiare. Të dhëna për akt akordimin e të ardhurave, për situacionin e shpenzimeve dhe të dhëna progresive mund të aksesohen edhe online në website të institucionit [<a href="https://univlora.edu.al/raporti-financiar/">https://univlora.edu.al/raporti-financiar/</a>].</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Në institucion kryejnë auditim të jashtëm edhe KLSH dhe MASR [<b>Evidenca J, Raporti vjetor për vitin akademik 2018-2019</b>].</p> <p>Në raportin financiar të 2018-2019 jepen të dhëna krahasuese edhe me vitet e mëparshme, <i>por nuk paraqiten ndërhyrje të posaçme dhe diversifikim të financimit të programit</i> [<b>Raporti financiar 2018-2019</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit bazuar në burimet financiare të siguruara nga granti i MASR. Zvogëlimi i vazhdueshëm i numrit të studentëve shoqërohet edhe me sigurimin tepër të limituar të burimeve financiare nga tarifat. <i>GVJ konstatoi se Departamenti nuk disponon projekte ose nuk ofron shërbime të tjera që sjellin të ardhura dhe ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të programit</i> [<b>RVB-Tabela e studentëve në hyrje dhe dalje në programin studimor Histori-Gjeografi</b> [<a href="https://univlora.edu.al/raporti-financiar/">https://univlora.edu.al/raporti-financiar/</a>].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës IV</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<b>X</b>	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloren e DE dhe rregulloren e programit Bachelor Histori-Gjeografi [<b>Udhëzim i MASR Nr. 10, dt. 15.05.2019, Evidenca C, Rregullore e UV, neni 39</b>]. Procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik fillojnë me regjistrimin e studentit në UV, frekuentimin e moduleve dhe lëndëve në tre vite së bashku me praktikën në terren,</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe</p>	

<p>procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>duke grumbulluar kreditet e nevojshme (ECTC) dhe konkludon me marrjen e diplomës pas mbrojtjes me diplomë ose provim <b>[Ligji 80/2015, Udhëzim i MASR Nr. 10, dt. 15.05.2019, Evidenca C, Rregullore e programit mësimor Histori-Gjeografi]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e pranimit, frekuentimit deri në përfundim të programit mësimor garantojnë barazinë për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët. Përzgjedhja e kandidatëve fitues bëhet në varësi të renditjes së studentëve në listat e raundeve të shpallura nga MASR. Të drejtat e kandidatëve dhe studentëve garantojnë në statutin e Universitetin si dhe në rregulloren e DE <b>[Statuti i UV, Rregullore e UV, Rregullore e DE, neni 19]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit të kandidatëve për studentë janë në përputhje me kriteret e përcaktuara nga MASR. Universiteti ndjek procedurat për transferimin e studentëve dhe njohjes së studimeve të mëparshme sipas udhëzimeve të MASR dhe sipas rregullores së UV <b>[Rregullore e UV, Kreu VI, neni 56,57,58, 59]</b>. Kriteret e pranimit dhe të vlerësimit të studentëve si dhe numri i kuotave publikohen online në ëbsite të institucionit. Kriter pranimit në nivelin bachelor është nota mesatare, që përcaktohet nga MASR si dhe numri i kuotave që përcaktohet nga institucioni në përputhje me udhëzimet e MASR.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kandidatët për studentë mund të jenë shqiptarë dhe të huaj, që plotësojnë kriterin e mesatares si dhe kanë bërë ekuivalentimin e shkollës së mesme në MASR, nëse e kanë kryer jashtë Shqipërisë. GVJ, nga verifikimi i dosjeve të studentëve dhe atyre të transferuar, gjeti të gjithë dokumentacionin që vërteton sa më sipër <b>[Vizitë e GVJ në sekretarinë mësimore, Rregullore e UV, Kreu VI, neni 56,57,58,59]</b>.</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni publikon kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve në funksion të kriterëve të përcaktuara nga MASR dhe nga rregullorja e Universitetit <b>[Statuti i UV, Rregullorja e UV]</b>. Kriteret publikohen online tek rubrika “Njoftime”. Aktualisht në website-n e UV tek kjo rubrikë, kriteret dhe procedurat e pranimit nuk janë të publikuara <b>[<a href="https://univlori.edu.al/2015/10/01/kriteret-dhe-procedurat-e-pranimit/">https://univlori.edu.al/2015/10/01/kriteret-dhe-procedurat-e-pranimit/</a>]</b>.</p> <p>Institucioni harton kritere të përgjithshme dhe specifike në përputhje me aktet ligjore të MASR dhe maturën shtetërore. Ashtu siç është përmendur dhe më lart, në statutin e Universitetit dhe rregulloren e DE cilësohet se në program mund të regjistrohen shtetas shqiptar dhe të huaj <b>[Statuti i UV, Rregullore e UV, Kreu VI, neni 56,57,58,59]</b>.</p> <p>Përpara çdo viti akademik, DE dhe institucioni, janë të angazhuar për informimin e publikut. Realizimi i disa fletëpalosjeve si dhe organizimi i disa takimeve në shkollat e Bashkisë Vlorë dhe Fier janë programuar për vitin në vijim <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik]</b>.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>




standardit				X
------------	--	--	--	---

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Institucioni informon studentët nëpërmjet website por edhe nga takimet e hapura me studentët të gjithë kriteret dhe procedurat e përparimit akademik. Kjo gjë u konstatua nga GVJ edhe nga takimi me stafin akademik dhe me studentët. Në <i>rregulloren e UV, rregulloren e programit Histori-Gjeografi</i> si dhe nëpërmjet sistemit UVMS studentët informohen për rezultatet e provimeve si dhe mund të regjistrohen online për provimet dhe përmirësimet [ <b>Rregullore e UV, Rregullore e programit Histori-Gjeografi</b> ], <a href="https://uvms.univlora.edu.al/user/login">[https://uvms.univlora.edu.al/user/login]</a> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni, nëpërmjet DE, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore informon studentët në takimet e hapura për procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme. Procedura e njohes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme është e përcaktuar në Rregulloren e UV [ <b>Rregullore e UV, Kreu VI, neni 56,57,58,59</b> ]. Në kreun VI të Rregullores së UV, neni 57 është parashikuar transferimi i studentëve të UV për në institucione të tjera. Procedura e transferimit përfshin një kërkesë nga i interesuari për tek zyra akademike, e cila ia përcjell Rektoratit për miratim. Në kreun VI të Rregullores së UV, neni 58, është parashikuar transferimi i studentëve të huaj në UV. Procedura e transferimit përfshin një kërkesë nga i interesuari për tek zyra akademike. Kërkesa dhe dokumentacioni përkatës i dërgohet Fakultetit përkatës jo më vonë se data 15 shtator. Komisioni i ekuivalentimit dhe vlerësimit (KEV), i ngritur pranë çdo departamenti, mbi bazën e dokumentacionit që dërgon universiteti përkatës, përcakton detyrimet që do të ketë studenti, nëse pranohet në atë degë, sipas planit mësimor në fuqi si dhe njohjen e shlyerjes së lëndëve me ekuivalencë. KEV brenda 3 ditëve i përcjell Dekanit të Fakultetit listën e studentëve të propozuar që plotësojnë kriteret e transferimit. Dekani i përcjell këtë listë zyrës akademike dhe për dijeni Rektorit, i cili merr vendimin për pranimin e studentëve të propozuar për transferim [ <b>Rregullore e UV, Kreu VI, neni 56,57,58,59</b> ].
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni në bashkëpunim me stafin akademik dhe Departamentin publikon syllabusin e çdo lënde ku janë të përcaktuar edhe kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. Nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se studentët informohen nga pedagogët për mënyrën e vlerësimit që në fillim të lëndës e përgjatë semestrit deri në fund [ <b>Syllabuset, Takimi i GVJ me studentët</b> ].  Institucioni nëpërmjet stafit akademik dhe sekretarisë mësimore informon



	<p>për kriteret dhe procedurat e diplomës. GVJ konstatoi se studentët ishin të mirë informuar për të gjitha procedurat <b>[Takimi me studentët]</b>.</p> <p>Departamenti ka parashikuar që në fund të çdo viti para fillimit të vitit të ri të organizojë takime të hapura të stafit me kandidatët për studentë në shkollat e mesme të Bashkisë Vlorë dhe Fier. Ata kanë hartuar udhëzuesin e studentit si dhe fletëpalosje informuese <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik, takimi me studentët, Udhëzuesi i studentit, fletëpalosje]</b>.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Studentët informohen për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit nëpërmjet Sekretarisë mësimore, zyrës së Studentëve, takimeve të hapura me Përgjegjësën e Departamentit dhe stafin akademik në fillim të vitit, si dhe ëëbsite të UV. Këtë e konfirmuan edhe studentët në takimin me GVJ <b>[Takim i GVJ me Dekanin, Përgjegjësën e DE, stafin akademik, studentët]</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion për modulet, lëndët, përmbajtjen, titullarët e lëndëve si dhe veprimtaritë formuese. GVJ verifikoi dhe konstatoi se informacioni vihet në dispozicion të studentëve në sekretaritë mësimore, afishohen në këndin informues të studentit, website të UV, komunikim i drejtëpërdrejtë nga stafi akademik, syllabuset, etj. <b>[Takim i GVJ me studentët, syllabuset]</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Institucioni informon studentët në takimet e hapura, panairët e punës si dhe nëpërmjet secilit anëtar të stafit akademik rreth mundësive të punësimit. Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se studentët ishin shumë të qartë për mundësitë e punësimit të tyre. Institucioni nëpërmjet zyrës së karrierës po krijon një databazë me studentët alumni, për të kuptuar dhe publikuar punësimin e tyre që ka lidhje me programin mësimor të ndjekur prej tyre <b>[Takimi i GVJ me studentët, <a href="https://univlora.edu.al/alumni/">https://univlora.edu.al/alumni/</a>]</b> .
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të përditësuar mbi zhvillimin e procesit mësimor, ose zëvendësimin e orëve të mësimit në raste të veçanta, duke shfrytëzuar stendat informuese të Fakultetit por edhe nëpërmjet ëëbsite dhe rrjeteve sociale të Fakultetit. Në ndihmë të informimit të studentëve vjen edhe Zyra e Studimeve dhe Studentëve të Fakultetit. Nga verifikimi i ambienteve të mësimdhënies,
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.	

	<p>GVJ konstatoi se sallat dhe sallonet janë të pajisura më informacion orientues të studentit. Orari me të dhënat e lëndës, sallës, leksion, seminar, pedagogut dhe numrit të studentëve publikohet në website të UV. Po kështu dhe datat e provimeve dhe riprovimeve [<b>Vizitë e GVJ në FGHH</b>, <a href="https://univloria.edu.al/orari-i-provimeve/">https://univloria.edu.al/orari-i-provimeve/</a>].</p> <p>Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të brendshëm të informacionit (sekretari mësimore, DE) dhe në website që është lehtësisht i aksesueshëm për të gjithë studentët. Në website të UV, Fakulteti i Shkencave Humane, tek Departamenti i edukimit jepet një përmbledhje e programeve të studimit që ofron ky departament, përfshirë dhe programin e studimit në Histori-Gjeografi. Përveç përmbledhjes, nuk jepen të dhëna të tjera online. <i>Programi i studimit dhe syllabuset duhet të jenë të plota online, që studentët apo kandidatët për studentë të informohen edhe në distancë.</i></p> <p>[<a href="https://univloria.edu.al/fakulteti-i-shkencave-humane/#">https://univloria.edu.al/fakulteti-i-shkencave-humane/#</a>].</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<p><b>Standardi V.4</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. GVJ pasi verifikoi regjistrin e regjistrimit të studentëve, regjistrin e notave dhe regjistrin e diplomimit të studentëve si dhe tabelat përmbledhëse të raportit të analizës mësimore vjetore konstatoi korrektesë në mbajtjen dhe regjistrimin e këtyre të dhënave [<b>Vizitë e GVJ me sekretarinë mësimore</b>].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ, pasi verifikoi regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e notave dhe regjistrin e diplomimit të studentëve si dhe tabelat përmbledhëse konstatoi se Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në ciklin e parë, numrin e studentëve të tërhequr nga programi apo largimet para përfundimit të programit [<b>Vizitë e GVJ me sekretarinë mësimore</b>].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna të detajuara për ecurinë e studentëve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto GVJ i konstatoi nga verifikimi i regjistrave dhe dosjeve personale të studentëve në sekretarinë mësimore. Dokumentacioni ruhet në formë të shkruar dhe në forme elektronike [<b>Vizitë e GVJ në Sekretarinë mësimore</b>].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë</p>	<p>Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të</p>

të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	brendshëm të informacionit nëpërmjet shkrimit me dorë në regjistra dhe në formë elektronike. Veprimet lidhur me të dhënat personale të studentëve kryen bazuar në parimin e konfidencialitetit, i garantuar në statutin e UV. Informacioni është i aksesueshëm dhe lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar <b>[Statuti i UV, neni 79]</b> .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Institucioni harton raportin vjetor, pjesë përbërëse e të cilit është edhe analiza e cilësisë në hyrje dhe në dalje të studentit që frekuenton programin mësimor. <i>Institucioni nuk disponon një analizë konkrete, por po punon në drejtim të studimit të tregut</i> nëpërmjet krijimit të databazës së alumni për punësimin e tyre dhe efektivitetin e ndjekjes së programit mësimor në punësim. Në databasën e alumni është përfshirë diplomimi dhe punësimi i tyre <a href="https://univlori.edu.al/alumni/">[https://univlori.edu.al/alumni/]</a> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Institucioni, në statutin dhe rregulloren e tij të brendshme dhe në përputhje me aktet ligjore të IAL-së, parashikon përfshirjen e studentëve në organet vendimmarrëse. Sipas statutit të UV, 10 përqind e Senatit akademik përfaqësohet nga studentët të cilët zgjidhen nga studentët <b>[Statuti i UV, kreu III, neni 17, pika 6]</b> . Dy përfaqësues të Senatit Akademik janë përfaqësues të zgjedhur të studentëve. Me nxitjen dhe mbështetjen institucionale studentët kanë zgjedhur Këshillin Studentor, një anëtar në Bordin e Administrimit si dhe nga një anëtar në komisionet e përhershme. Nga takimi me studentët sa më sipër iu konfirmua GVJ <b>[Ligji 80/2015, Statuti i UV, kreu III, neni 17]</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni mundëson sipas udhëzimeve dhe akteve ligjore në fuqi të MASR praninë e studentëve të zgjedhur në Senatit Akademik, dhe në komisionet e përhershme si dhe në Bordin e Administrimit <b>[Statuti i UV, kreu III, neni 17, 22]</b> . Kjo mundëson që kontributi i tyre në vendimmarrje të jetë konkret. Gjithashtu, aplikimi i pyetësorëve dhe analizimi i përgjigjeve të tyre përfshihet në raportet e analizës vjetore të cilësisë së mësimdhënies. GVJ nga takimi me studentët konstatoi se studentët ndihen pjesë në vendimmarrje, këshillim apo vlerësim të procesit akademik <b>[Takimi i GVJ me studentët]</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të	Institucioni ka të përcaktuar në rregulloren e tij njohjen e studimeve të pjesshme apo të plota të mëparshme <b>[Rregullore e UV, Kreu VI, neni 56,57,58,59]</b> . GVJ konstatoi se në programin mësimor nuk tejkalohet ngarkesa mësimore prej 25 orë mësimore në javë. Departamenti po

mëparshme.	angazhohet në njohjen ose ekuivalentimin e lëndëve në raste mobiliteti të programit Erasmus. GVJ, nga takimi me stafin akademik dhe me studentët konstatoi se përmirësimi i programit nga ana e stafit lidhur me kërkesat e tregut ka ende hapësirë për përmirësim <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik, takimi me studentët]</b> . Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se një nga arsyet e mos aplikimit të studentëve për mobilitete Erasmus është mos ekuivalentimi i lëndëve <b>[Takimi i GVJ me studentët]</b> . Nisur nga praktika e mirë e mobiliteteve të studentëve të programeve të tjera të studimit të UV, stafi akademik dhe ndihmës akademik i këtij programi mësimor duhet të nxisë aplikimin e studentëve për mobilitete duke i informuar dhe sqaruar studentët që, ekuivalentimi i lëndëve dhe njohja e mobiliteteve të tyre, janë të garantuara në rregullore <b>[Rregullore ICM, nenet 15, 16]</b> .			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Institucioni po realizon plotësimin e pyetësorëve me studentët para përfundimit të çdo lënde dhe rezultatet e pyetësorëve i reflekton në raportin dhe analizën vjetore të departamentit. Kjo është një mënyrë indirekte e përfshirjes së opinionit të studentëve për përmirësimin e programit mësimor. <i>Megjithatë, nga takimi me studentët, GVJ konstatoi se studentët nuk janë të përfshirë drejtëpërdrejtë në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit mësimor</i> <b>[Takimi i GVJ me studentët]</b> . Institucioni duhet të punojë për përfshirjen e rregullt të studentëve në hartimin dhe rishikimin e programit të studimit duke gjetur mënyra dhe instrumenta të tjerë (përveç pyetësorëve) që kontributi i tyre të jetë konkret, i matshëm dhe efektiv.			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregullorja e brendshme e UV garanton se studentët kanë mundësinë e informimit dhe ankimit mbi ndershmërinë e vlerësimit të kontrollit të dijeve si dhe mundësinë e rishikimit nga ana e pedagogut <b>[Evidenca C-Rregullore e UV, neni 62, 70]</b> . Studentëve u jepet gjithashtu mundësia e dhënies së opinionit të tyre nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve në mënyrë anonime <b>[Takimi i GVJ me studentët]</b> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

<b>Standardi V.6</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Institucioni ka njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e UV. Drejtoria e Edukimit për ciklin e I dhe II ka në përbërje të saj Sektorin e Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe aktiviteteve kulturore-sportive si dhe Sektorin e Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve me një përfaqësues në shërbim të studentëve për FSHH

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p><a href="https://univlori.edu.al/administrata/">https://univlori.edu.al/administrata/</a>.</p> <p>Në statutin e UV është përcaktuar procedura e informimit të studentit. Koordinatori për marrëdhënie me studentin është anëtar i stafit akademik i njësisë bazë, i emëruar nga drejtuesi i njësisë bazë për të koordinuar marrëdhëniet e Departamentit me studentët. Koordinatori kryen promovimin e programeve të studimit të ofruara nga njësia bazë. Informon, orienton dhe këshillon studentët për veprimtarinë mësimore dhe aktivitete të tjera. Ai ofron këshillim për zhvillimin e karrierës në njësinë bazë. Ai këshillon studentët për problematika të ndryshme dhe raporton problematikën e tyre në departament [<b>Statuti i UV, Kreu VII, neni 77</b>]. Gjithashtu në rregulloren e UV theksohet që Këshilltarët akademikë mund t'i ndihmojnë studentët të përpilojnë planin e tyre të studimit, si dhe të verifikojnë që të gjitha detyrimet e kursit të shlyhen në kohën e duhur apo t'i orientojnë për zgjidhjen e çdo problemi tjetër akademik [<b>Rregullore e UV, Kreu X, neni 85</b>].</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur një sistem të posaçëm dhe funksional për informimin, këshillimin dhe asistimin e studentëve. Ky sistem përbëhet nga: Sekretaria mësimore; Koordinatori për marrëdhënie me studentët (<i>rol i të cilit është shpjeguar më lart</i>); Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumni dhe i aktiviteteve kulturore-sportive, me një specialist të zyrës së studentit; Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve, me një përfaqësues në shërbim të studentëve për FSHH. <a href="https://univlori.edu.al/administrata/">https://univlori.edu.al/administrata/</a>.</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni institucioni ju ofron studentëve shërbimin e këshillimit në mënyrë periodike. Kjo njësi ka hartuar edhe një rregullore për informimin e studentëve dhe të stafit akademik për mobilitete. Kjo zyrë gjithashtu pret dhe organizon takime me studentët për këshillim karriere si dhe organizon “Ditën informuese”. [<b>Takimi i GVJ me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Takimi me studentët</b>].</p> <p>Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, e krijuar vitet e fundit, po krijon dhe pasuron një databazë për studentët alumni. Këtë databazë e publikon në website të institucionit. GVJ u informua nga përfaqësues të kësaj zyre se kjo databazë është në proces plotësimi si dhe verifikoi databazën aktuale online në website të institucionit. Institucioni u jep mundësi që alumni të regjistrohen përmes Formularit të regjistrimit UV Alumni [<a href="mailto:alumni@univlori.edu.al">alumni@univlori.edu.al</a>].</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
--	------------------------------	-------------------------------------	--	-------------------------------------

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Për sigurimin e cilësisë së brendshme, Institucioni ka politika të shprehura në Strategjinë e Institucionit 2018-2024, Statutin dhe Rregulloren e UV. Në Statutin e UV cilësohet se, struktura në nivel institucional për sigurimin e brendshëm të cilësisë, është Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional (KSBCI). Funkcionet kryesore të këtij komisioni janë garantimi i standardeve të cilësisë së institucionit në aspektin akademik dhe administrativ <b>[Statuti I UV, Kreu III, neni 22]</b> . KSBCI i kushton një rëndësi të veçantë procesit mësimor për çdo program studimi. Procedura e funksionimit të KSBCI është e përcaktuar në rregulloren e institucionit. KSBCI minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor nxjerr rekomandimet përkatëse të cilat ia adreson autoriteteve apo organeve drejtuese.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në nivel fakulteti funksionon Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të cilësisë të Fakultetit (KSBCF). Funkcionet kryesore të këtij komisioni janë garantimi i standardeve të cilësisë të institucionit në aspektin akademik dhe administrativ <b>[Statuti I UV, Kreu III, neni 21]</b> . KSBCF i kushton një rëndësi të veçantë procesit mësimor për çdo program studimi. Procedura e funksionimit të KSBCF është e përcaktuar në rregulloren e institucionit. KSBCF minimalisht në përfundim të çdo sezoni mësimor nxjerr rekomandimet përkatëse të cilat ia paraqet KSBCI të institucionit, autoriteteve apo organeve drejtuese <b>[Statuti I UV, Kreu III, neni 21, pika c, ç, d, dh]</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	KSBCI dhe KSBCF operojnë në përputhje me aktet ligjore të IAL, statutin e UV dhe vendimet e senatit. Nga takimi me përfaqësues të KSBCI, GVJ konstatoi punën e këtij komisioni për analizimin e pyetësorëve realizuar me studentët për cilësinë e mësimdhënies dhe programit mësimor. Nga ky takim GVJ konstatoi se ky komision i komunikon rezultatet e pyetësorëve stafit akademik, të cilët hartojnë një sërë masash për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies <b>[Takimi i GVJ me përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë]</b> .
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Institucioni po punon për ngritjen dhe forcimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë <i>si një nga objektivat e strategjisë</i> 2019-2024 të institucionit. Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve. Kjo njësi bashkëpunon dhe asiston komisionin

	<p>e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore në kryerjen e funksioneve të tyre <b>[Statuti i UV, Kreu VIII, neni 80]</b>.</p> <p>Studentët janë të përfshirë me përfaqësues të tyre në Komisionet e Përhershme të Sigurimit të Cilësisë. GVJ konstatoi nga takimi me përfaqësues të kësaj drejtorie se janë bërë hapa të rëndësishme drejt realizimit të objektivave, por akoma janë në proces forcimi <b>[Takimi i GVJ me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve]</b>.</p> <p>Institucioni përdor instrumentat e Akreditimit institucional dhe të akreditimit të programeve për sigurimin e cilësisë <b>[Statuti i UV, Kreu VIII, neni 80, pika 3]</b>. Institucioni ka kaluar fazën e akreditimit institucional në vitin 2017 për një periudhë tre vjeçare (<b>Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 71, datë 21.09.2017</b>). Akreditimi institucional është realizuar përmes procesit të vlerësimit të jashtëm të akreditimit. Aktualisht institucioni është në fazën e akreditimit të programeve të studimit, pjesë e të cilit është edhe programi Bachelor në “Histori-Gjeografi” <b>[Statuti i UV, Kreu VIII, neni 80, pika 3]</b>.</p> <p>Institucioni ka hartuar politika dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programevetë studimeve. Këto politika dhe procedura janë të pasqyruara në statutin dhe rregulloren e UV. Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit operon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila organizon dhe analizon pyetësorët e studentëve në fund të semestrit. Nga takimi me përfaqësues të kësaj njësie GVJ u njoh nga afër me procedurën dhe planin e veprimit për përmirësimin e programeve pas analizimit të pyetësorëve. Procedura e përmirësimit të programeve është ajo e analizimit të pyetësorëve, evidentimi i problematikave, dërgimi i tyre në Departamentin përkatës (sektori i programit të studimit), i cili e bën objekt diskutimi në mbledhjen e stafit akademik. Në raste ku del nevoja e ndryshimit ose përmirësimit të programit të studimit, propozimet e stafit akademik kthehen në një plan veprimi afatshkurtër dhe afatgjatë për ndryshimin dhe përmirësimin gradual të programit mësimor. Nga takimi me stafin akademik si dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, GVJ konstatoi se një praktikë e tillë është në procedurë diskutimi dhe aplikimi për të ardhmen <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik, Takimi i GVJ me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë]</b>.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

#### Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni ka ngritur njësi të posame për monitorimin, shqyrtimin dhe rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. Si njësi e posaçme për hapjen, monitorimin dhe rishikimin e programeve në institucion është Sektori i Kurrikulave dhe Shërbimit ndaj Studentit (<i>si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Edukimit për ciklin e parë dhe dytë</i>) së bashku me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucional. <b>[Statuti I UV, Kreu III, neni 22].</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Mekanizmat që përdor institucioni për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të ciklit të parë janë formale dhe jo formale. Mekanizmat formalë ndjekin procedurën diskutim në Departament për rishikim, ndryshime, propozim për ndryshime të programit drejtuar Drejtorisë së Edukimit për ciklin e parë dhe dytë, e cila më pas ia kalon për miratim Senatit akademik. Mënyra jo formale është analizimi i pyetësorëve dhe reflektimi i mendimit të studentëve për programet në mbledhjen e departmentit. GVJ nga takimi me stafin akademik konstatoi se programi ka nevojë për ndryshime (<i>heqjen ose pakësimin e lëndëve fizike dhe shtimin e lëndëve humane, futja e hartografisë digjitale</i>). <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik].</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni përdor metodologjinë e analizimit dhe interpretimit të pyetësorëve lidhur me performancën e stafit akademik, syllabuseve dhe programit mësimor. Kjo është realizuar dy vitet e fundit nga NJSBCVI ku në vitin pasardhës shihet një vlerësim më pozitiv se ai paraardhës, e përkthyer në përqindje. Gjithashtu institucioni analizon performancën e personelit akademik për çdo vit lidhur me programin mësimor ku janë të angazhuar. Në fund të vitit akademik 2019-2020 pritet të realizohet edhe pyetësori me studentët për cilësinë e shërbimit të stafit ndihmës akademik dhe administrativ ndaj studentëve. GVJ nuk kishte një raport apo të dhëna të një formulari të tillë, pasi në kohën e vizitës ende nuk ishte realizuar <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik dhe përfaqësues të NJSBCVI].</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimeve të pyetësorëve, NJSBCVI, i pasqyrojnë në raportin e pyetësorëve shoqëruar me rekomandimet përkatëse. Ky raport dhe rekomandimet diskutohen në Departament në funksion të përmirësimit të performancës si dhe rishikimit të programit mësimor. Kjo u konfirmua GVJ nga stafi akademik dhe përfaqësues të NJSBCVI në takimet me to <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik dhe përfaqësues të NJSBCVI].</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raporti i vlerësimit i realizuar dy vitet e fundit përfshin rezultatet e vlerësimit. Nga takimi me përfaqësues të NJSBCVI, GVJ konstaton disa nga masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngritja e një njësi të brendshme në nivel departamenti;</li> <li>- Për 2017-2018 janë realizuar të gjitha masat (<i>përmirësimi i pyetësorit, përmirësimi i laboratoreve, përpunimi i të dhënave automatikisht,</i></li> </ul>



	<p><i>përpilimi i pyetësorit për stafin ndihmës akademik dhe administrativ, etj);</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për këtë vit akademik është bërë edhe një analizë krahasuese me vitin e mëparshëm dhe në këtë program studimi është vërejtur përmirësim;</li> <li>- Nga analiza e pyetësorëve është vënë re një rënie me 11.4 % të përgjigjes së studentëve të cilët mendonin se mësimi ishte i mërziqshëm [Takimi i GVJ me përfaqësues të NJSBCVI].</li> </ul>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>NJSBCVI realizon çdo vit në fund të çdo semestri pyetësorët me studentët për performancën e stafit akademik, ngarkesën mësimore, syllabuset, etj, rezultatet e të cilit i reflekton në raportin vjetor të pyetësorëve. Institucioni realizon vlerësimin e brendshëm periodik (çdo vit) realizuar nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm në bashkëpunim me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm është pjesë e vetëvlerësimit institucional në kuadër të akreditimit institucional dhe të programeve. Kjo konfirmohet nga Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të vënë në dispozicion të GVJ si dhe nga takimi me grupin e punës të RVB [RVB, Takimi i GVJ me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metodën e analizimit të pyetësorëve me studentët, si dhe metodën e diskutimeve në Departament mbi përputhshmërinë dhe përshtatjen e programit mësimor me tregun e punës, organizimin e workshopeve [Workshopi “Studentët dhe tregu i punës”], analiza e të dhënave të punësimit të studentëve alumni, si dhe diskutime informale të pedagogëve me studentët. Metoda që përdor aktualisht institucioni për përfshirjen e opinionit të studentëve është ajo e analizës së të dhënave sasiore të pyetësorit dhe interpretimit të rezultateve. Instrumenti i përdorur është pyetësori që realizohet me studentët. <i>GVJ mendon që institucioni dhe DE për vlerësimin e programit mësimor duhet të përdorë edhe instrumenta të tjerë përveç atyre të përmendura më sipër. Të tillë mund të përmendim përdorimin e disa indikatorëve mes përputhjes së programit mësimor dhe tregut të punës, indikatorë të koherencës së programit mësimor me programe mësimore të ngjashme në Shqipëri ose jashtë vendit, etj.</i> [RVB, Takimi i GVJ me Përgjegjës të DE, stafin akademik].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metodën e anketimit me</p>

profesionet e e rregulluara dhe të tjera.	studentët dhe diskutimit në Departament. Kontrollë të drejtpërdrejta në procesin mësimor (leksione dhe seminare) janë parashikuar por nuk janë realizuar pasi kjo çënon lirinë akademike. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve nuk janë realizuar [ <b>Takim i GVJ me stafin akademik, Takimi me studentët</b> ].			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metodën e krahasimit të numrit të studentëve që zgjedhin këtë program mësimor në raport me programet e tjera, numrin e të punësuarve pas përfundimit të studimeve, numrin e studentëve që vazhdojnë kualifikimin në të njëjtin drejtim. Megjithatë nga takimi me përfaqësues të NJSBCVI dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se aplikimi i metodave të tërthorta si sondazhe apo ndjekja e ecurisë së Alumni është në fazat e para dhe ka hapësirë për tu përmirësuar [ <b>Takimi i GVJ me përfaqësues të NJSBCVI, Takimi me stafin akademik</b> ].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni ka parashikuar përfshirjen e aktorëve të ndryshëm ( <i>staf akademik, staf ndihmës akademik, staf administrativ dhe studentët</i> ) për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Përfshirja e aktorëve të ndryshëm garantohet në Statutin, Rregulloren si dhe në Strategjinë e zhvillimit 2019-2024 [ <b>Statuti, kreu VIII, neni 81, 82, 83; Regullore e UV, neni 86, Plani strategjik 2018-2024, Objektivat strategjike</b> ].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni në Statutin dhe Rregulloren e UV ka përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, komisionet e përhershme, studentët, etj. për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit [ <b>Statuti, neni 21, 22</b> ]. Nga takimi me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, Përgjegjës të DE, përfaqësues të NJSBCVI, GVB, studentët, stafin akademik, përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Projekteve, GVJ konstatoi se institucioni garanton ushtrimin e këtyre detyrave duke u dhënë pavarësi veprimi [ <b>Takimet e GVJ me Dekanin, Përgjegjës të DE, stafin akademik, studentët, përfaqësues të NJSBCVI</b> ].
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit njësia

personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.	kryesore është e përfshirë nëpërmjet NJSBCVI. Njësia bazë është e përfshirë drejtpërdrejtë si hartuese dhe zbatuese e programit të studimit. Studentët përfshihen nëpërmjet pyetësorëve <b>[Statuti, neni 22]</b> .			
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ nuk ka indikatorë që të masë përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit, por nga takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi respektim të integritetit akademik dhe mungesë të diskriminimit <b>[Takimet e GVJ me stafin akademik, studentët]</b> .			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ nuk ka të dhëna të dokumentuara që vërtetojnë përfshirjen e ekspertëve të jashtëm që kanë lidhje me programin. Në takimin me stafin akademik dhe Përgjegjësin e Departamentit si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, <b>GVJ nuk konstatoi përfshirjen e drejtpërdrejtë të ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë</b> . Në mënyrë indirekte janë bërë përpjekje nga Institucioni për marrjen e mendimit të bashkëpunëtorëve, ish kolegëve dhe studentëve nëpërmjet workshopit “ <i>Studentët dhe tregu i punës</i> ” si dhe nga takime informale të tjera <b>[Takimi i GVJ me stafin akademik dhe Përgjegjësin e Departamentit]</b> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	UV përdor website e tij për rritjen e transparencës në lidhje me komunikimin me studentët dhe stafin akademik. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të cilësisë për programin e studimit bëhen publike në kuadër të Statutit, Rregullores, vendimeve të Senatit akademik dhe Raportit të analizës së pyetësorëve [ <a href="https://univlora.edu.al/">https://univlora.edu.al/</a> ].
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni harton Raportin e analizës së pyetësorëve me studentët për cilësinë e mësimdhënies dhe të programit mësimor për secilin department. Ky raport publikohet në njësinë kryesore duke respektuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në përmbushje të vendimit të KM Nr.531, dt.11.09.2018 “ <i>Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë</i> ”. Raporti publikohet online në ëbsite të institucionit <b>[RVB, citimi 421]</b> .
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të	Nga takimi me përfaqësues të NJSBCVI, GVJ u informua se rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash që synojnë përmirësimin e

evidentuara.	mangësive të evidentuara [ <b>Takimi i GVJ me përfaqësues të NJSBCV</b> ].			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni vlerëson efektivitetin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. GVJ e konstatoi këtë edhe nga takimi me stafin akademik, anëtarët e të cilit kanë filluar të familjarizohen me këtë praktikë duke kuptuar impaktin pozitiv të vlerësimit të cilësisë në azhurnimin e programit në përputhje me kërkesat e tregut dhe të nivelit ndërkombëtar [ <b>Takimi i GVJ me stafin akademik</b> ].			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni nëpërmjet njësisë bazë organizon takime ose workshope me studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me impaktin e studentëve në përmirësimin e cilësisë së programit. GVJ e konstatoi këtë edhe në takimin me studentët [ <b>Takimi i GVJ me studentët</b> ].			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Histori-Gjeografi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Ismail Qemali”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Karakteri i dyfishtë i programit (Histori dhe Gjeografi), mundëson studentët të thellojnë njohuritë e tyre në disa fusha studimi në ciklet pasardhëse, dhe siguron më shumë mundësi punësimi në tregun e punës.
2. Strategjia e ndërkombëtarizimit në rang institucional, e shtrirë edhe në rang Fakulteti dhe Departamenti.
3. Plani strategjik i zhvillimit në rang Departamenti, në të cilin përfshihet edhe programi Bsc. Histori-Gjeografi.
4. Rregullore, udhëzues dhe procedura të mirëpërcaktuara për funksionimin e procesit mësimor.
5. Një sistem funksional për sigurimin e brendshëm të cilësisë, në të cilin ishin përfshirë edhe studentët (cilësinë e mësimdhënies).
6. Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve.
7. Nxitja institucionale dhe mbështetja financiare për pjesëmarrjen e stafit akademik në konferenca ndërkombëtare.
8. Një platformë digjitale efikase për realizimin e komunikimit të stafit akademik me studentët për vlerësimin e tyre (sistemi UVMS).
9. Infrastrukturë e re dhe funksionale në shërbim të studentëve dhe stafit akademik.

**Pika të dobëta:**

1. Rënia e vazhdueshme e numrit të studentëve hyrës në programin mësimor “Histori-Gjeografi” katër vitet e fundit nga 58 në vitin akademik 2016-2017, deri në 6 studentë për vitin 2019-2020.
2. Mungesa e studimeve të mirëfillta për tregun e punës, në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.
3. Mungesë e teksteve bazë të gjeografisë si dhe e literaturës bashkëkohore të autorëve të huaj dhe vendas në bibliotekën e FSHH në dispozicion të studentëve.
4. Mungesa e komisionit të përhershëm të sigurimit të cilësisë në nivel Institucional.
5. Përfshirja minimale e stafit akademik në projekte shkencore vendase dhe ndërkombëtare pavarësisht mbështetjes dhe nxitjes institucionale që kanë.
6. Numër relativisht i vogël i publikimeve shkencore të stafit akademik të botuara në revista ndërkombëtare të indeksuara.
7. Mungesë e mobiliteteve të studentëve jashtë vendit si dhe mobilitete të pakta të stafit akademik.
8. Mungesë e një laboratorit IT me GIS software për krijimin e hartave digjitale.
9. Mungesë e informacionit të detajuar të programit mësimor dhe syllabuseve online.

## Rekomandime:

1. Të rritet promovimi i këtij programi studimi nëpërmjet një fushate informuese dhe sensibilizuese për afrimin e studentëve në këtë program studimi. Të azhurnohet gradualisht programi i studimit “Histori-Gjeografi” në drejtim të kurrikulave me tendencën e përgatitjes së specialistëve që kërkon tregu i punës si dhe të realizohet ekuivalentimi ose përafrimi i programit mësimor me programe të ngjashme të huaja.
2. Të realizohet një studim i tregut për të kuptuar kërkesat e kohës, trendet dhe perspektivën e punësimit që ka lidhje me këtë program mësimor si dhe të reflektohen gjetjet e këtij studimi në programin mësimor.
3. Të rritet fondi për pasurimin e bibliotekës së FSHH duke siguruar kopje të teksteve bazë dhe të literaturës bashkëkohore në dispozicion të studentëve.
4. Të ngrihet sa më shpejt komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë.
5. Të ndryshohet raporti mësimdhënie dhe punë shkencore i stafit akademik, në mënyrë që stafi të angazhohet edhe me punë kërkimore dhe projekte.
6. Të rritet numri i publikimeve shkencore të stafit akademik të botuara në revista ndërkombëtare të indeksuara. Të punohet për përputhjen ose përafrimin e profilit shkencor të stafit akademik me mësimdhënien.
7. Të rritet numri i mobiliteteve të studentëve dhe stafit akademik jashtë vendit.
8. Të krijohet një laborator IT me GIS software për hartografinë digjitale.
9. Të pasurohet website i Institucionit me informacion të detajuar për programin e studimit si dhe syllabuset e këtij programi, shqip dhe në gjuhën angleze, në mënyrë që studentët apo kandidatët për studentë të informohen edhe në distancë.
10. Institucioni, sugjerohet të bëjë një marrëveshje me AADF (Fondin Shqiptar Amerikan të Zhvillimit) për të bërë të mundur implementimin e Clean Score për provimit, e cila do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe përmirësimin e sistemit të sigurimit të cilësisë.

## Conclusions of the External Evaluation of the first cycle study program, Bachelor in “History-Geography”, of “Ismail Qemali” University, Vlorë

### Strengths and affirmations:

1. The dual character of the program (History and Geography), enables the students to deepen their knowledge in several fields of study in subsequent levels and provides more employment opportunities in the labor market.
2. The internationalization strategy at the institutional level, extended to the Faculty and Department level.
3. Strategic development plan at the Department level, which includes also the Bch. “History-Geography” study program.
4. Regulations, guidelines and well-defined procedures for the functioning of the learning process.
5. A functional system for internal quality assurance, in which students were also involved (for teaching quality).

6. Institutional level guide for the development and use of various and innovative teaching methods based on the field of study, subjects and modules.
7. Institutional encouragement and financial support for the participation of academic staff in international conferences.
8. An efficient digital platform for the communication of the academic staff with the students concerning their evaluation (UVMS system).
9. New and functional infrastructure in the service of students and academic staff.

### **Weaknesses:**

1. The continuous decrease of the number of students entering the History-Geography study program in the last four years, from 58 for the 2016-2017 academic year, to 6 students for the 2019-2020 academic year.
2. Lack of genuine studies of the labor market, in line with national development strategies, national interest and global development trends.
3. Lack of basic textbooks of geography as well as contemporary literature of foreign and local authors in the library of FSHH available to students.
4. Lack of a permanent quality assurance commission at the Institutional level.
5. Minimal involvement of academic staff in local and international scientific projects despite their institutional support and encouragement.
6. Relatively small number of scientific publications of academic staff published in international indexed journals.
7. Lack of student mobility abroad as well as low academic staff mobility.
8. Lack of an IT laboratory with GIS software for digital cartography.
9. Lack of detailed curriculum and syllabuses information online.

### **Recommendations:**

1. Increase the promotion of this study program through an information campaign for bringing students closer to this study program. Gradually update the study program "History-Geography", in terms of curricula with the tendency to prepare specialists required by the market and equivalencation or approximation of the curriculum with similar foreign programs.
2. Conduct a market study to understand the current requirements, trends and employment prospects related to this curriculum and to reflect the findings of this study in the curriculum.
3. Increase the fund for the enrichment of the FSHH library to provide copies of basic textbooks and contemporary literature to students.
4. Establish a permanent quality assurance commission as soon as possible.
5. Change the ratio of teaching and scientific research of the academic staff, so that the staff gets more time to engage in research and projects.
6. Increase the number of scientific publications of academic staff in international indexed journals and match the scientific profile of the academic staff with the teaching.
7. Increase the number of student mobility and academic staff abroad.

8. Create an IT lab with GIS software for digital cartography.
9. Enrich the website of the Institution with detailed information about the study program and the syllabuses of this program, both in Albanian and English, so that the students or candidates for students can access the information in distance.
10. The institution, is suggested to make an agreement with AADF (Albanian American Development Fund) to implement the Clean Score for exams, which will help to increase the transparency and improve the quality assurance system.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof. Dr. Merita DOLLMA
2. Prof. Asoc. Dr. Çlirim DURO



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE			X	
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>			<b>X</b>	